

AKSIDENTE

Uikendi la pas rrugë të përgjakura



Fq.6

KONKURRENCA EKONOMIKE

Maqedonia e fundit në Evropë



Fq.7

Sportin e kam si profesion

Rasim Ramadani



Fq.12

Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3490 · e hënë-e martë, 22-23 tetor 2018

15°C | 20°C

15 DEN



KOHA për sport

Fq.12-15

ANALIZË

Ballkani, vija e re e frontit midis SHBA e Ruisë



23 vjet pas marrëveshjeve që iu dhanë fund masakrave në Bosnjë, fantazmat e konflikteve etnike e fetare dhe frika e një lufte të re të tmerrshme kthehet të trazonjë Ballkanin. Nga Bosnja në Kosovë e deri në Maqedoni, tre ish-republika jugosllave teatër i luftërave civile dhe ndërhyrjeve të huaja midis 1992 e 2002...

Fq.2

RAJON

Plagjiatura e akademikëve, si përgjigjet Nexhat Daci?

Fq.16

AKTUALE

Gjermani: Deri në 2060, nevojiten 17 milionë profesionistë

Fq.9



PAS INICIMIT TË NDRYSHIME KUSHTETUESE

PARLAMENTI, NË SPROVËN E RADHËS



Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë pritet që nga e hëna të filloj procedura për formimin e komisionit për pajtim, një nga katër kërkesat e deputetëve të VMRO-së të cilët votuan për ndryshimet kushtetuese. Pritet që Kuvendi me së paku 61 vota do të votojë propozim amendamentet, dhe më pas do të diskutohet publikisht, për një periudhë kohore që cakton Kuvendi. Për amendamentin për Preambulën e Kushtetutës, përveç dy të tretave duhet edhe shumica e Badenterit

Fq.3

LSHB, Nazmi Jakurti zgjidhet kryetar i ri

Shkup, 21 tetor-Lidhja Shqipëtare në Botë,(LSHB) të dielën në Shkup, ka mbajtur kongresin e saj të tretë zgjedhor. Në këtë kongres kanë marrë pjesë udhëheqësia e Lidhjes Shqipëtare në Botë, përfaqësues të politikës, shoqërisë civile dhe delegat të shumtë nga mbarë viset shqiptare. Pjesë e këtij kongresi kanë qenë edhe kryetari i parë Mikel Kuzhnin. Kryetari i deritanishëm Simon Kuzhnini, foli për rëndësinë e Lidhjes Shqiptare në Botë dhe kërkoi që të krijohet

edhe një Akademi Kombëtare e Shqiptarë dhe të shkruhet njëherë e përgjithmonë historia e shqiptarëve. Gjatë fjalimit të tij, zv.Kryeministri Bujar Osmani para të pranishmëve ekskluzivisht deklaroi se po bëhet përpjekje për rrumbullakimin e idesë që shumë shpejtë në fushën e Stenkovecit të ndërtojmë qendrën më të madhe të holokaustit shqiptar në përkujtim të gjithë atyre të dëbuarve në luftën e Kosovës që u pritën në Maqedoni

Fq.5



BALLKANI, VIJA E RE E FRONTIT MIDIS SHBA E RUSISË

Nga Gian Micalessin

Në qershor 1991, Sekretarit i Shtetit i SHBA, James Baker, përsëriste "nuk kemi një qen në atë luftë", duke lënë të kuptohet indiferencën thelbësore të Shteteve të Bashkuara përballë përplasjes midis serbëve, kroatëve e myslimanëve. 27 vjet më pas, Washingtoni ka pozicione shumë më të qarta. Armiqtë që duhen bllokuar nga strategjitë e Departamentit të Shtetit e të Pentagonit janë Rusia e Vladimir Putin dhe miqtë e saj të supozuar serbë, ndërsa aleatët për t'u mbrojtur janë myslimanët e Bosnjës, pakicat shqiptare në Maqedoni dhe qeveria e Kosovës. Gjithçka me mbështetjen jokritike të euroburokratëve të Brukselit, të paafte për të pasur një vizion autonom e të pavarur edhe për çështje që kanë të bëjnë me kontinentin e vjetër. Por problemi i vërtetë, siç u pranua më 2015 nga John Kerry, Sekretari i Shtetit në administratën Obama, është që Ballkani sot është "vija e kuqe" në përballjen midis NATO-s e Rusisë.

Kjo është më tepër se kurrë e dukshme në Maqedoni. Në këtë republikë të vogël, Aleanca Atlantike dhe Bashkimi Evropian, të përkuarura nga Shtetet e Bashkuara, kanë bërë gjithçka për të bindur zgjedhësit të votonin "PO" në referendumin e 30 shtatorit për ndryshimin e emrit në Maqedonia e Veriut, sipas programit të kryeministrit Zoran Zaev, aleat besnik i Brukselit e Washingtonit. Referendumi do t'i jepte fund edhe mosmarrëveshjes me Athinën, kundërshtarë që më 1991 e hyrjes së Shkupit në BE dhe në NATO, me frikën se emri Maqedoni do të justifikonte në të ardhmen pretendime mbi rajonin grek me të njëjtin emër. Por referendumi, vendimtar për ta hequr Maqedoninë nga zona e influencës ruse që përkrah opozitën nacionaliste, rezultoi një vrimë në ujë.

Megjithatë ftesat dhe presionet për "PO", shoqëruar nga vizitat në Shkup të kancelares gjermane Angela Merkel, të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg dhe, "e ëmbla në fund" të Sekretarit të Mbrojtjes të SHBA, Jim Mattis, i cili shkoi në kryeqytetin maqedonas në vigjilje të votimit, vetëm 37% e zgjedhësve shkuan drejt qendrave të votimit.

Kështu, pavarësisht votimit 91% për PO, referendumi është i pavlefshëm për mosarritjen e shifrës 50% në pjesëmarrje. Megjithë suksesin e dukshëm të opozitës nacionaliste, që favorizoi bojkotin, BE, NATO e SHBA i kanë kërkuar kryeministrit Zaev të mos dorëzohet, duke mbështetur vendimin për ta kaluar adoptimin e emrit të ri përmes votimit në parlament me shumicë absolute.

Një vendim i dyshimtë konstitucionalisht që megjithatë përgjegjësjë për politikën e jashtme në BE, Federica Mogherini, e ka përcaktuar si "një mundësi unike për pajtimin në Ballkan". Por edhe këtu fitorja është gjithçka përveçse e sigurt. Pas debatit të nisur të hënën e shkuar, qeveria e drejtuar nga socialdemokrati Zaev dhe e mbështetur nga pakica myslimane, ka dhjetë ditë kohë për të siguruar 80 vota nga 120 gjithsej që i japin dy të tretat e nevojshme.

Një objektiv në dukje i pamundur, pasi nacionalistët kanë të paktën 49 vende. Por për të bërë ndryshimin mund të mendojë magjistruara. Pikërisht më 16 tetor nisi edhe procedimi për heqjen e imunitetit dhe garantuar arrestimin e një duzine parlamentarësh nacionalistë të akuzuar për përgjim të kundërshtarëve politikë. Kjo lojë do t'i garantonte kuorumin Zaevit, ndërsa NATO, BE dhe SHBA do të fitonin një copëz të re rebusit kompleks ballkanik. Por do të ishte një copëz eksplozive që mund të thyhet nën presionin e brendshëm dhe të shkaktojë konfrontime të ngjashme në rajonet fqinjë.

Në Kosovë, për rikthimin e frikës dhe mosbesimit kontribuojnë deklaratat jo shumë të kujdesshme të John Bolton, këshilltar i sigurisë kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, të shprehura në fund të gushtit për shkëmbimin e territoreve mbi bazat etnike. Projekti i Boltonit do të garantonte rikthimin e zonave veriore me shumicë serbe nën kontrollin e Beogradit, ndërsa Lugina e Preshevës, banuar nga shumicë shqiptare, por zyrtarisht serbe, do t'i kalonte Prishtinës.

Kthimi i konceptit të ndarjes etnike, pavarësisht zemërimit anti-rus që karakterizon Boltonin, premtion të çojë ujë në mullirin e serbëve të Bosnjës, ose të miqtë më të mirë të Moskës që favorizojnë idenë e shkëputjes nga ajo lloj minifederate e tipit jugosllav vendosur në kohët e Daytonit.

Gjatë atyre bisedimeve, pikërisht vullneti për të kthyer në bashkëjetesë komunitetet e ndara nga lufta çoi në vendimin për t'i dhënë jetë një Bosnje të ndarë midis kroatëve, boshnjakëve dhe myslimanëve, por të qeverisur nga një presidencë me rotacion, njësoj si ajo e shpikur për Jugosllavinë e Mareshalit Tito.

Suksesi në votimet e 8 tetorit i Milorad Dodik, lideri nationalist i serbëve të Bosnjës, kërcënon shkatërrimin e mekanizmit të vënë në punë në Dayton 23 vjet më parë. I përkrahur nga rusët, të rikthyer me Putin si mbrojtës të mëdhenj të kombit serb, Dodik kërcënon të prishet me presidencën me rotacion e të shtyjë serbët e Bosnjës drejt vetëvendosjes dhe pavarësisë.

Një hap që kërcënon të prishë të gjithë mekanizmat e paqimit dhe që do të garantonte, pikërisht falë pozicionit të këshilltarit të Sigurisë Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, një sukses të ri të Moskës në zemër të atij Ballkani të transformuar në një tjetër "vijë fronti" në konfrontimin midis SHBA e Rusisë.

Demokracia japoneze po sprovohet në Kosovë

"Thelbi i demokracisë perëndimore është që fituesit të zgjedhjeve t'ia jap pushtetin politik, ndërsa humbësit t'i kalojnë në rolin monitorues dhe kontrollues. Kryeministri është përgjegjës i zbatimit të programit të qeverisë dhe në emër të tij ndëshkon dhe shpërblen ekipin e tij. Demokracia japoneze e qeverisjes nuk e pranon këtë model. Atje nuk ka fitues dhe humbës. Kryeministrit, nuk i lejohet të shkarkojë ministrat dhe as anëtarët e tjerë dhe të marrë ndonjë masë që nuk e miratojnë anëtarët e koalicionit. Ata nuk i pranojnë vendimet personale të tij, por ato i marrin me bindje, pas konsultimeve të gjata. Poashtu, kryeministrit nuk i lejohet të japë as urdhëra, por në vend të tyre ai duhet të ofrojë debatin për bindje. Ai nxit dhe kujdestaron arritjen dhe ruajtjen e konsensusit. Nga pamundësia e zbatimit të modelit perëndimor, Kosova aktualisht po e zbaton këtë aziatik! Dalja me suksesin e këtij modeli të qeverisjes te ne, do të ishte zbulim që duhet të shpërblehet, jo vetëm me heqjen e vizave, por me integrim të menjëhershëm në BE!", ka shkruar ish deputeti dhe veprimtari, Nijazi Idrizi, në profilin e tij në Facebook.

Po du me ju kallëzu diçka që kenaqeni tuj keshë

"Kuptohet që portalin e Radio Kosova e Lirë nuk e shihni se çka shkruan. Nuk ka shumë lexueshmeri. Është pronë e një bashkëshpiktarit tim, të Krojmirit. Ahmet Qeriqit. Nuk jemi keq si katund. Dy media i kemi. Vec edhe një TV me shtrirje nacionale na mungon. Bahet edhe kjo, ne te ardhmen. Ama, une kenaqem tuj kesh me kete bashkëshpiktarin tim. Eshte i gjenerates se vjeter. Tash, duhet edhe me kuptu. Eshte i asaj gjenerates qe i duket interesante me u kap mahalla me mahalle. Kënaqet tërë kohën duke shkruar kundër meje. Herë me më fute në lista të gazetareve mercenar, herë në lista të gazetareve me mendësi serbe, herë te gazetareve UDB-ash. Edhe sot më paska futur në një liste të tillë. Plus paska konkludu që na anëtarët e kesaj liste e kemi hak "dajakun e munguar". Edhe e paska kritikua Policinë e Kosoves qe me ka dhene leje per pajisje me armë. Me demek, ka kontribu në rritjen e sigurisë të një mercenari apo UDB-ashi. Zot, bane hajr", ka shkruar një status në Facebook, gazetari, Parim Olluri

LLAMBA ELEKTRIKE NDRIÇUESE NISI SUKSESIN PARA 139 VITEVE

Shpikësi Thomas Edison më 21 tetor të vitit 1879, filloi provat për një tjetër lloj filamenti për llambën e tij elektrike ndriçuese. Llamba bëri dritë për 40 orë, duke shënuar eksperimentin e parë të suksesshëm të Edisonit me llambën elektrike, pas mijëra dështimesh në provat laboratorike në Menlo Park të New Jersey-it. Çelësi i suksesit ishte përdorimi i një filamenti prej karboni të hollë sa një fije floku, e cila ndriçonte por nuk shkrihej nga nxehtësia që krijonte elektriciteti. Ai deklaroi para punonjësve të laboratorit: "Nëse arrita ta bëj të ndriçojë për 40 orë, mund ta bëj të ndriçojë për 100 orë." Në bazë të kësaj llambe, Edison filloi të punonte për ndërtimin e sistemit të parë të suksesshëm të ndriçimit, i cili pas disa kohësh do të furnizonte me energji 85 shtëpi që kompania e tij i kishte pajisur me qarqe elektrike dhe llamba ndriçimi në qytetin e New Yorkut.



NËSE NUK E KENI DITUR...

MEDIA Citate

Fond sekret grek për mediat në Shqipëri e Maqedoni

Ministria e jashtme greke raportohet se ka financuar me fondet sekrete mediat në Shqipëri dhe Maqedoni. Lajmi ka qarkulluar në mediat elektronike greke, në kohën që partia më e madhe opozitare kërkon nga qeveria që të publikohen të gjitha detajet. Sipas një ligji të iniciuar nga ish ministri i jashtëm, Nikos Kotzias, përdorimi i fondeve sekrete të ministrisë, shqyrtohet nga një komision i parlamentit.

"Shqyrtimi i fundit është bërë më 10 tetor. Dosja që u hap në zyrën e kryetarit të parlamentit përmbante tre kode, për një fond prej 1 milion eurosh."

"Të njëjtat burime thonë se kodi i parë ishte për para që iu dhanë mediave në Shqipëri, i dytë për media në Shkup dhe i treti për mbështetjen e kishave ortodokse.

Sqarimi që u dha për dy kodet e para, ishte se janë përdorur me qëllim që të publikohen shkrime pozitive për Greqinë dhe të lobohet me gazetarë e drejtues medias në dy vendet fqinje në dobi të interesave të Greqisë." Gjithsesi, kryetari i parlamentit Nikos Voutis, tha se "shkakton indignatë publikimi i gjoja shpenzimeve sekrete të MPJ, ndërsa krijon pikëpyetje serioze mbi qëllimet dhe synimet e politikanëve dhe mediave që i riprodhojnë këto lloj 'lajmesh'." Shfrytëzimi i fondeve sekrete ishte një nga pikat e debatit të ashpër që u zhvillua të martën ndërmjet ministrit të jashtëm dhe ministrit të mbrojtjes Kammenos, që çoi në dorëheqjen e Kotzias. Partia më e madhe opozitare, Demokracia e Re, ka kërkuar që të publikohen të gjitha detajet nga transaksionet e fondeve sekrete të Ministrisë së Jashtme dhe të Mbrojtjes.

"Menaxhimi i fondeve shtetërore nuk është një çështje që ka të bëjë vetëm me ekuilibrat brenda qeverisë, por i intereson gjithë shoqërisë greke. Qeveria dhe personalisht zoti Tsipras duhet t'u japin përgjigje të pastra qytetarëve", thuhet në deklaratën e Demokracisë së Re.

Vetë qeveria ka akuzuar partinë më të madhe opozitare dhe kryetarin e saj, Kyriakos Mitsotakis. "Publikimi i gjoja informacioneve mbi disponimin e fondeve sekrete dëmton direkt interesat kombëtarë dhe është rezultat i mizerabilitetit të Demokracisë së Re dhe zotit Mitsotakis", nënvizon zyra e shtypit e kryeministrit grek.

"Nëse zoti Mitsotakis dëshiron të informohet për fondet sekrete, të kërkojë menjëherë takim me kryeministrin", përfundon reagimi i qeverisë.

(CNN Greek, 21 tetor)

PAS INICIMIT TË NDRYSHIME KUSHTETUESE

PARLAMENTI, NË SPROVËN E RADHËS

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë pritet që nga e hëna të filloj procedura për formimin e komisionit për pajtim, një nga katër kërkesat e deputetëve të VMRO-së të cilët votuan për ndryshimet kushtetuese. Pritet që Kuvendi me së paku 61 vota do të votojë propozim amendamentet, dhe më pas do të diskutohet publikisht, për një periudhë kohore që cakton Kuvendi. Për amendamentin për Preambulën e Kushtetutës, përveç dy të tretave duhet edhe shumica e Badenterit



draftit të amendamenteve të Kushtetutës me sqarim, propozuesi e dorëzon deri te kryetari i Kuvendit, i cili e dorëzon deri te deputetët, presidenti dhe Qeveria, kur nuk janë propozues, më së voni 30 ditë përpara mbajtjes së seancës së Kuvendit.

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë pritet që nga nesër të filloj procedura për formimin e komisionit për pajtim, një nga katër kërkesat e deputetëve të VMRO-së të cilët votuan për ndryshimet kushtetuese që e paraqitën deri në Kuvendi.

Nga e premtja para mesnatës janë edhe pesëmbëdhjetë ditë, aq afat ka Qeveria për dorëzimin e propozim amendamenteve të Kushtetutës në Kuvend. Pritet që Kuvendi me së paku 61 vota do të votojë propozim amendamentet, dhe më pas do të diskutohet publikisht, për një periudhë kohore që cakton Kuvendi. Propozim amendamentet duhet të shqyrtohen edhe nga Komisioni për drejtësi dhe çështje kushtetuese dhe në fund vendoset në seancë plenare.

Vendimi përfundimtar për votimin e amendamenteve bëhet me votën e dy të tretave të shumicës në Kuvend, ose së paku 80 vota. Për amendamentin për Preambulën e Kushtetutës, përveç dy të tretave duhet edhe shumica e Badenterit, ndërkaq kryetari i Kuvendit vendos se kur do të caktohet seance parlamentare për propozimit të ndryshimit të Kushtetutës.

Shqyrtimi në Kuvend bëhet sipas tekstit të draftit të çdo amendamenti veç e veç dhe mund të shihen mendime dhe propozime. Shqyrtimi mund të zgjatë më së shumti tre ditë pune sipas tekstit të draftit të çdo amendamenti veç e veç. Kuvendi cakton afat për zbatimin e diskutimit publik, mënyrën e publikimit të draftit të amendamenteve dhe afat në të cilin pro-

pozuesi si bartës i diskutimit deri në Kuvend dorëzon raport për rezultatet nga diskutimi publik dhe tekst të propozimit të amendamenteve të Kushtetutës. Amendamentet për ndryshim të Kushtetutës miratohen me shumicë prej dy të tretave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (80 deputetë).

ZAEV: NA PRET MIRATIMI I AMENDAMENTEVE

"Ky është moment historik, i falënderohemi çdo deputeti që morri guximin dhe tejkaloi interesat partiake, për të zgjedhur të ardhmen e vendit. Unë si kryeministër do të mbaj llogari për sigurinë tuaj dhe të familjeve të juaja. Udhëtimi jonë drejtë BE-së dhe NATO-së sapo ka filluar, na pret shumë punë që këtë rrugë ta bëjmë më të shkurtër. Na pret miratimi i amendamenteve. Duhet të fokusohemi në realizimin e reformave. Duhet ta vazhdojmë këtë që e filluam sot dhe kthim pas nuk ka. Jam i bindur që bashkë Maqedoninë do ta shprijmë drejtë një të ardhme më të mirë", deklaroi të premtën mbarma Zoran Zaev, kryeministri i Maqedonisë.

Ali Ahmeti: Rruga jonë drejt NATO dhe BE - kthim prapa s'ka

Në një reagim publik, kryetari i BDI-së Ali Ahmeti ka falënderuar "secilin prej jush për përkrahjen e dhënë në këto kohëra vendimtare dhe për besimin e bartur tek ne për ta marrë vendimin e duhur. Njëkohësisht, shpreh mirënjohje të jashtëzakontë edhe për 80 deputetët që votuan për, ndërsa edhe ato që deshën të votojnë për, por nuk e gjetën dot guximin për ta bërë gjënë e duhur mbrëmë, i ftoj që të na bashkangjiten ne procedurat e mëtejme për rrumbullakësim të këtij procesi. Nuk lë dot pa përmendur edhe ato që punuan tashmë me javë të tëra në rrethana të vështira për të ardhë deri te ky

sukses fillestar! Rruga jonë drejt NATO dhe BE është njëdrejtimëshe, kthim prapa s'ka. Vetëm bashkë jemi më të fortë", ka thënë Ali Ahmeti.

MBËSHËTJETE NGA BRUKSELI DHE UASHINGTONI

Shtetet e Bashkuara përhëndetën vendimin e Kuvendit të Maqedonisë për aderim në ndryshimet kushtetuese që rrjedhin nga marrëveshja e Prespës. Shtetet e Bashkuara besojnë se mundësi historike për të forcuar stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e të gjithë rajonit.

"Unë dua të përgëzoj të gjitha forcat politike në vend, dhe veçanërisht lidhshimin e saj në këtë vendim të rëndësishëm", tha Nimic për Zërin e Amerikës pas votimit. Dua të shpreh kënaqësinë time të madhe për rezultatin e arritur në Parlament.

"Ky është një hap i mirëpritur jo vetëm për vendin tuaj, por edhe për rajonin dhe për Evropën. Dua të përgëzoj të gjitha forcat politike në vend dhe lidhshimin e saj në mënyrë të veçantë për këtë vendim të rëndësishëm," u shpreh Nimic. Ai theksoi se ishte veçanërisht i kënaqur me mënyrën se si funksionoi sistemi demokratik në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, si dhe frymën demokratike të qytetarëve.

Përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, Federica Mogherinidhe eurokomisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn, përmes deklaratës së përbashkët, e kanë përhëndetur vendimin e parlamentit të Maqedonisë për qasjen drejt ndryshimeve të Kushtetutës në pajtim me Marrëveshjen e Prespës.

"Parlamenti ka bërë një hap shumë të rëndësishëm drejt zba-

mit të Marrëveshjes së Prespës përmes votimit për fillimin e procedurës për ndryshime kushtetuese. Tani presim që procedurat kombëtare për zbatimin e marrëveshjes të vazhdojnë pa anulime, drejt miratimit të ndryshimeve kushtetuese", thonë Mogherini dhe Hahn.

Edhe qeveria greke e konsideron hap pozitiv dhe të madh shumicën e siguruar prej dy të tretave për ndryshimet kushtetuese. Zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Xanopoulos, ministri alternativ i Punëve të Jashtme, Jorgos Katrugalos dhe ministri për Politikë Digjitalë, Nikos Papas kanë dhënë konsideratat e tyre për këtë ngjarje.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përhëndeti vendimin e parlamentit maqedonas për t'u qasur drejt ndryshimit të Kushtetutës në pajtim me Marrëveshjen e Prespës.

Edhe presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk ka përhëndetur miratimin e ndryshimeve kushtetuese duke porositur se Maqedonia është një hap më afër bashkësisë euroatlantike.

"Një votë, një hap i madh më afër marrjes së vendit që u takon në bashkësinë tonë transatlantike", ka shkruar Tusk në Twitter, në gjuhën maqedonase

TIRANA DHE PRISHTINA UROJNË SHKUPIN ZYRTAR

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta përhëndeti votimin në parlament pro ndryshimeve kushtetuese, kurse në një postim në Twitter, kryeministri Rama uroi për "lindjen" e kësaj republike të re, ndërsa nuk ngurroi të komplimentojë kryeministrin Zoran Zaev dhe të gjithë ata që punuan për të arritur këtë sukses.

Pas votimi në Kuvendin e Maqedonisë ku u vendos për emrin e ri të këtij shteti, edhe liderët institucional të Kosovës kanë uruar qytetarët e Maqedonisë për këtë arritje.

RUSIA NUK E PRANON NDRYSHIMIN E EMRIT TË MAQEDONISË

Rusia nuk e pranon ndryshimin e emrit. Pas votimit në Kuvendin e Maqedonisë, nëpërmjet profit në rrjetin social "Twitter" të ambasadës ruse, Rusia dërgoi një mesazh ku thotë se e pranon Maqedoninë nën emrin e saj kushtetues dhe se këtë qëndrim nuk do ta ndryshojë. "Rusia e ka njohur Republikën e Maqedonisë me emrin e saj kushtetues më shumë se para 26 vjetësh dhe nuk do ta ndryshon qëndrimin e saj", shkruan në profilin e ambasadës ruse në Shkup. (F.P)

Shkup, 21 tetor – Të premtën mbrëmë, Kuvendi i Maqedonisë me 80 vota "për" dhe 39 "kundër" e miratoi vendimin për iniciimin e ndryshimeve kushtetuese për të implementuar Marrëveshjen e Prespës, ndërsa me 75 vota "për" ka vendosur që Qeveria si propozues i ndryshimeve më së voni në afat prej 15 ditëve të përgatit propozim amendamente të Kushtetutës dhe t'i dorëzojë deri te Kuvendi. Me këtë është zhbllokuara edhe rrugëtimi euroatlantik i shetit, pas dështimit të referendumit me moskalim të pragut prej 50 përqind. Pas këtij votimi, komisionet duhet të hartojnë ndryshimet, për t'u rikthyer më pas në votimin e dytë dhe të fundit në seancë plenare. Këto ndryshime janë të domosdoshme për zbatimin e marrëveshjes me Greqinë për ndryshimin e emrit të Maqedonisë në Maqedoni e Veriut.

SI DO TË JETË PREAMBULA E KUSHTETUTËS SË RE?

Marrëveshja, që u arrit verën e këtij viti në Prespë, pritet t'i hapë rrugë Maqedonisë drejt anëtarësitë në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Qëkur Maqedonia ka shpallur pavarësinë në vitin 1991, Greqia i ka bllokuar përpjekjet e saj për euro-integrim, duke këmbëngulur se me emrin Maqedoni, fqinji i saj mund të ketë pretendime territoriale ndaj një rajoni grek me të njëjtin emër.

Ndryshimet në Kushtetutën e Maqedonisë parashohin ndryshimin e preambulës dhe të neneve tjera. Nga ana tjetër, pas votimit të hapjes së procedurës për ndryshime kushtetuese. Pritet që teksti i

Shkup, 21 tetor - Udhëheqësia e VMRO-DPMNE-së dhe Hristijan Mickoski janë marioneta antimaqedone dhe antiperëndimore të penguar në tentimet të bllokojnë të ardhmen e Maqedonisë. Mickoski dhe udhëheqësia e tij antiperëndimore janë të mposhtur nga partia e tyre dhe nuk arritën të bllokojnë rrugën e Maqedonisë drejt BE-së dhe NATO-s, ka reaguar sot LSDM përmes një kumtese për media, transmeton MIA.

“80 deputetë në Kuvend lirshëm, sipas bindjeve të tyre dhe në procedurë demokratike votuan për të ardhmen e BE-së dhe NATO-s dhe e respektuan vullnetin e mbi 80 për qind të të gjithë qytetarëve. Maqedonia po bashkohet rreth të ardhmes në BE dhe NATO. Mickoski dhe udhëheqësia antiperëndimore e VMRO-DPMNE-së mbeten të izoluar në të kaluarën e errët dhe ndasitë”, thuhet mes tjerash në kumtesën e LSDM-së.

Partia opozitare maqedonase VMRO akuzon LSDM së bashku me kryeministrin Zoran Zaev, duke thënë se ata e shkelën demokracinë dhe ligjin në Republikën e Maqedonisë.

“Zoran Zaev dhe 80 të dëshpëruarit e tij nuk fituan mandat në zgjedhje për të ndryshuar Kushtetutën, të fshijnë emrin e Republikës së Maqedonisë dhe të ndryshojnë identitetin. Zoran Zaev dhe 80 të dëshpëruarit nuk fituan mbështetje as në referendum për të fshirë historinë, traditën dhe kulturën e

PËRPLAJSE LSDM – VMRO

AKUZA TË NDËRSJELLA PËR TË ARDHMEN E VENDIT



Republikës së Maqedonisë. LSDM dhe Zoran Zaev e shkelën demokracinë dhe ligjin në Republikën e Maqedonisë. Duke mos pasur guxim të përballet me vullnetin e qytetarëve i cili ishte i qartë në referendum, Zaev u drejtua në dhunimin e institucioneve, shtetit dhe vullnetit të popullit të vet”, thuhet në njoftimin e VMRO-së.

“Me këtë miratim të dhunshëm

të ligjeve kundër vendimit të popullit dhe mbledhjes së dhunshme të votave në Kuvend nën kërcënimet e persekutimit politik, LSDM dhe Zoran Zaev e humbën legjitimitetin për të folur për vlera demokratike dhe evropiane. Ajo që i ndodhi Maqedonisë është turp dhe precedent që nuk ka asgjë të përbashkët me demokracinë. Me këtë akt LSDM-ja dhe Zaev i dhanë fund

karrierave të tyre. Shumë shpejt do të duhet të përballen me qytetarët, ndërsa atëherë ky pushtet kundër popullit dhe jodemokratik do të shkojnë në histori. Maqedonia dhe populli shumë herë në histori janë përballur me vështirësi por çdoherë kanë dalë fitimtarë, sepse populli asnjëherë nuk ka hequr dorë nga vendi i tyre”, thuhet më tej në njoftim.



Ali Ahmeti i shkruan letër lamtumirëse Nikos Koxias

Pas dorëheqjes së ministrit të Jashtëm Grek, Nikos Koxias, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, i ka shkruar një letër.

“I dashur mik Nikos, me dëshpërim e pranova lajmin për dorëheqjen tënde nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Greqisë pasi që tashmë katër vite po punojmë bashkarisht për vlera evropiane, fqinjësi të mirë, rajon të paqte, stabilitet, siguri. Bashkëpunimi jonë ishte i natyreshëm sepse na bashkonin bindjet gjeostrategjike dhe gjeopolitike jo vetëm për vendet tona por edhe për rajonin dhe më gjërë, vullneti për zgjidhje të çështjeve midis Shkupit dhe Athinës, por edhe pikëpamjet për marrëdhëniet me Shqipërinë e Kosovën.

Dua të të falënderoj jashtëzakonisht shumë për përkushtimin dhe për kontributin tënd të madhë për paqë, për mbyllje të çështjeve me fqinjët dhe për një Evropë Juglindore tërësisht të integruar në NATO dhe në BE. Jam i bindur që bisedat tona të gjata, miqësore dhe shumë të sinqerta do të vijojnë bashkë me angazhimin e përbashkët për vlerat të cilat i ndajmë bashkarisht.

Të uroj shumë shëndet, mbarësi dhe tek unë do gjes gjithëmonë derë të hapur për t'i realizuar bindjet tona për një rajon të zhvilluar dhe të integruar”, thuhet në letërën e Ali Ahmetit.

“E majta” do të organizojë protesta

Shkup, 21 tetor - Partia politike “E majta” do të organizojë protesta në çdo fazë pasuese të votimit mbi ndryshimet kushtetuese. Protestat do të jenë antiqeveritare, dhe do të organizohen para Kuvendit dhe do të jenë nën moton “Vetëmbrojtja e Popullit”. Siç thonë nga atje, qëllimi i tyre do të jetë kthimi në sovranitetin të rrëmbyer nga populli.

“Veprimet radikale radikale ditore, në koordinim me të gjithë aktorët politikë të cilët kundërshojnë ndryshimin e emrit kushtetues, do të merren sistematikisht



në territorin e Republikës. Ne u bëjmë thirrje të gjitha forcave progresive që të bashkohen me ne në lëvizje, deri në fitoren përfundimtare. Kur padrejtësia bëhet ligj, Rezistenca është detyra jonë”, thuhet në thirrjen e së “Majtës”.

Me thirrjen për rezistencë masive qytetare, “E majta” ka tri kërkesa: Pëzullimin e pakushtezuar të iniciativës jokushtetuese dhe të paligjshme të qeverisë për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe anulimin e të ashtuquajturës “marrëveshja e Prespës”, Shpërndarja urgjentet Kuvendit dhe caktimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, formimi i një qeverie teknike kalimtare me një mandat të kufizuar vetëm për zhvillimin e zgjedhjeve të drejta dhe demokratike.

Grubi: Në ndryshimet kushtetuese nuk do të hapim tema shqiptare

Deputeti i BDI-së Artan Grubi ka theksuar se Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) nuk do të hap çështjen e shqiptarëve gjatë procedurave të ndryshimit të Kushtetutës. Në emisionin ‘Hapur’ në 1TV me Aleksandar Comovskin, Grubi ka thënë se hyrja në BE dhe NATO është një nga prioritetet e BDI dhe nuk do të rezikojë që të shuaj këtë proces me kërkesa të tjera. BDI nuk do të kërkojë ndryshim të Kushtetutës për të drejtat e shqiptarëve.



Rregullohet parku përballë Ambulancës së Çairit

Shkup, 21 tetor - Ndërmarrja Publike “Parqe dhe Gjellbërime”-Shkup që nga orët e para të mëngjesit ka nisur rregullimin e parkut përballë Ambulancës së Çairit, ku hapësira e lënë pas dore për më shumë se 2 dekada tashmë është kthyer në një fushë të gjelbërt, e mbjellë me lule dhe fidane të reja si dhe me vendosjen e një kreativiteti të punuar nga punëtorët e NP “Parqe dhe Gjellbërime”. “Po ja dhuroj Çairit edhe një kreativitet tjetër. E mbani se në çfarë gjendje ishte ky park para deri disa muajve?! Epo tani do jetë një ndër parqet e juaja favorite. Falënderit kolegeve të NP “Parqe dhe Gjellbërime” që edhe pse sot është ditë e diel dhe me shi, ata nuk kanë ndaluar punën e tyre intensive me qëllim që sa



më shpejt këtij parku ti jepet jetë dhe qytetarët të mund ta përdorin dhe ta shijojnë pa fund. E pra duroni edhe disa ditë dhe ky park do jetë një ndër parqet më të bukura në Çair”, ka shkruar në faqen e tij të facebook-ut, drejtori i përgjithshëm i NP “Parqe dhe Gjellbërime” Ardijan Muça,

informon Medial. Që nga emërimi i drejtorit shqiptar, NP “Parqe dhe Gjellbërime” ka nisur aksion të madh për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra në nën e majtë të Shkupit ose siç shprehet drejtori Muça, “në anën e qytetit të lënë pas dore dekada me radhë”.

Gjatë fjalimit të tij, zv.Kryeministri Bujar Osmani para të pranishmëve ekskluzivisht deklaroi se po bëhet përpjekje për rrumbullakimin e idesë që shumë shpejtë në fushën e Stenkovecit të ndërtojmë qendrën më të madhe të holokaustit shqiptar në përkujtim të gjithë atyre të dëbuarve në luftën e Kosovës që u pritën në Maqedoni

Koha Urim HASIPI

Shkup, 21 tetor -Lidhja Shqipëtare në Botë,(LSHB) të dielën në Shkup, ka mbajtur kongresin e saj të tretë zgjedhor. Në këtë kongres kanë marrë pjesë udhëheqësia e Lidhjes Shqipëtare në Botë, përfaqësues të politikës, shoqërisë civile dhe delegat të shumtë nga mbarë viset shqiptare.Pjesë e këtij kongresi kanë qenë edhe kryetari i parë Mikel Kuzhnin.Kryetari i deritanishëm Simon Kuzhnini, foli për rëndësinë e Lidhjes Shqiptare në Botë dhe kërkoi që të krijohet edhe një Akademi Kombëtare e Shqiptarëve dhe të shkruhet njëherë e përgjithmonë historia e shqiptarëve.

OSMAN: NË STENKOVIC DOTË NGRITET QENDRA MË E MADHE E HOLOKAUSTIT SHQIPTAR

Zëvendëskryetari i Qeverisë për çështje evropiane, Bujar Osmani, i ftuar në Kongresin e III të lidhjes së shqiptarëve në botë, ku përveç kryesisë dhe delegatëve të Lidhjes së Shqiptarëve në botë ishin prezentë edhe shume personalitete tjera nga sfera te ndryshme, Biznesi, kultura, arti, gjithashtu prezent ishte edhe zëvendës Kryeministri i Kosovës z. Enver Hoxhaj,

“Shqiptarët gjithandej jetojnë momentet më të ndritshme në historinë tonë kombëtare, me një Sh-

SHKUPI,NIKOQIRI KONGRESIT TË III TË LIDHJES SHQIPTARE NË BOTË

NAZMI JAKURTI ZGJIDHET KRYETAR I RI



tova Lazim Destani.Ai tha Lidhja Shqiptare në Botë ka luajtur një rol të rëndësishëm në proceset e rëndësishme për shqiptarët.Gjatë këtij kongresi janë ndarë mirënjohje për personalitet të shquara shqiptare.

PROJEKTET MBARËKOMBËTARE

Pas punimeve të sotme të këtij kongresi kryetar është zgjedhur Nazmi Jakurti. Kongresi i parë është mbajtur në Prizren, i dyti në Tiranë dhe i treti është mbajtur sot në Shkup. Në statsutin e ri të Lidhjes-Shqipëtare në Botë qëndron se prioritet do të jetë bashkimi shpirtëror i shqiptarëve, anëtarësimi në NATO, ngritja e institutive për çështje strategjike kombëtare, themelimi i një Banke mbarëkombëtare, themelimi i një Akademie mbarëkombëtare e cila do të themelohej me vendim të kuvendeve të Kosovës dhe të Shqipërisë, hartimi i abetares për të gjithë nxënësit shqiptarë, hartimi i Enciklopedisë Shqiptare, Teatri Mbarëkombëtar, Kinostudio.

qipëri në NATO dhe e cila rrugëton sigurt në rrugën drejt Bashkimit Evropian, me një Kosovë e pavarur dhe e lirë e cila para disa ditëve formon edhe ushtrinë e vet dhe me një Maqedoni me avancim të rrollit të shqiptarëve në pozicionin e tyre shtet-formues dhe shtetndërtues”, theksoi në mes tjerash Osmani

Gjatë fjalimit të tij zv.Kryeministri Osmani para të pranishmëve ekskluzivisht deklaroi se po bëhet përpjekje për rrumbullakimin e idesë që shumë shpejtë në fushën e Stenkovecit të ndërtojmë qendrën më të madhe të holokaustit shqiptar në përkujtim të gjithë atyre të dëbuarve në luftën e Kosovës që u pritën në Maqedoni por edhe për të përkujtuar të kaluarën por edhe për të ndërtuar një platformë e cila do të jetë e mjaftueshme për pajtimin e popujve që

është e vetmja garanci për një rajon stabil i orientuar drejt integritimit në strukturat euro-atlantike.

Ndërkaq Zëvendëskryeministri I Qeverisë së Kosovës Enver Hoxhaj, theksoi se roli kësaj lidhje ka qenë i madh dhe nënvizoi se shqiptarët në Ballkan gjatë 30 viteve të fundit kanë shënuar rezultate të mëdha, dhe këta rezultate priten që të rriten akoma më shumë në të ardhmen.Ai në emër të qeverisë së Kosovës uroi miratimin e ndryshimeve kushtetuese në kuvendin e Maqedonisë dhe nënvizoi se javën që e lëmë pas u shënuan dy ngjarje të mëdha duke theksuar hapjen e rrugës për krijimin e Ushtrisë së Kosovës dhe ndryshimet kushtetuese në Maqedoni.

Mesazh që sa më shumë të investohet në vendbanimet shqiptare dërgoi biznesmeni i njohur ngaTe-



Lazim Destani: Duhet siguri për investitorët nga diaspora

Biznesmeni tetovar Lazim Destani i cili është edhe Kryetar Nderi i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare, ka thënë se afaristët e diasporës kanë drojë dhe frikësohen të investojnë në Kosovë, edhe pse interesimi dhe vullneti i tyre është tejet i madh.

Biznesmeni me prejardhje nga Tetova ka porositur ekzekutivin kosovar që të bëjë më shumë për të lehtësuar procedurat burokratike që ekzistojnë në Kosovë.

Në një intervistë për Kosovapresin ai ka thënë se ka shumë kompani të mëdha të shqiptarëve në diasporë, të cilat do të vijën dhe do të investojnë në Kosovë dhe në vendet shqiptare nëse rritet siguria për investime. Sipas Destanit kompanitë më të fuqishme shqiptare janë në Gjermani. Ai ka thënë se Kosova përveç investitorëve shqiptarë të diasporës ka shumë të interesuar edhe investitorë të huaj, sepse tha se, Kosova dhe viset tjera në rajon janë shumë të pashfrytëzuara.

Mungesa e prokurorëve anulon seancat

Shkup, 21 tetor- Për një vit e gjysmë (nga viti 2017 deri në qershor të vitit 2018), në Gjykatën Penale të Shkupit janë anuluar gjithsej 672 gjykime, prej të cilave 650 u anuluan në Njësitin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, për shkak të mungesës së prokurorëve, tregojnë të dhënat e publikuara për “Makfax” të cilat i mori nëpërmjet qasjes së lirë deri tek informacionet me karakter publik.

Nga Njësia e Shkupit thonë se, “ju informojmë se pas kontrollimeve të kryera në sistemin AKMIS është konstatuar se në periudhën e sipërpërmendur për shkak të mungesës së prokurorëve publik në Njësinë e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në kuadër të kësaj gjykate, janë anuluar 22 seanca kryesore, ndërsa në Njësinë e Penales për të rritur gjithsej janë anuluar 650 seanca kryesore”. Sasho Rajçev, shefi i prokurorisë së Shkupit, tha se arsyeja për shtyrjen e seancave ishte ndër të tjera mungesa e prokurorëve, si dhe kapaciteteve teknike dhe personelit të institucionit që duhet të ndjekin penalisht.

GJUHA SHQIPE EDHE NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK

Shkup, 21 tetor-Emërtimi dhe përkujtimi i kafshëve dhe objekteve tjera në Kopshtin Zoologjik të Shkupit, përveç gjuhës maqedonase, është bërë edhe në gjuhën shqipe. Reagimet dhe kërkesat e shumta të qytetarëve shqiptar të Shkupit, por edhe të vizitorëve që vijnë nga qytet tjera, përshi edhe ato nga Kosova, paraqesin arsyen kryesore zbatimi të dygjuhësisë edhe në këtë institucion kulturor të Qytetit të Shkupit. Në një prononcim për mediat në gjuhën Maqedone, drejtori i ri i Kopshtit Zoologjik, Gjorgji Galetanovski, ka thënë se emrat e kafshëve janë shënuar edhe në gjuhën shqipe.

“Tabelat momentale me emrat e kafshëve janë shënuar në



maqedonisht, anglisht dhe në gjuhën shqipe. Në ato vende nuk ka hapësirë për tekste shtesë. Ndërkohë, ne kemi porositur tabela informative, që lidhen me sigurinë e kafshëve dhe të njëjtat

prite të arrijnë në periudhën që vijon. Tekstet edhe në këto tabela do të jenë në dy gjuhë, maqedonisht dhe shqip”, ka thënë drejtori Galetanovski.

Zbatimi i dy gjuhësisë në ni-

velin e Shkupit është normë ligjore që është dashur të zbatohet vite më parë. Përveç emërimit të disa rrugëve dhe shesheve, në të kaluarën shqipja në Shkup ishte e panjohur. Administrata e kaluar e Qytetit të Shkupit ndonëse vazhdimisht premtonte se gjuha shqipe do të zbatohet në të gjitha institucionet e qytetit, ajo megjithatë bëri shumë pak që kjo dispozita ligjore të praktikohet. Ndryshe, kreu aktual i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, në disa deklarata të tija publike ka theksuar se ndarja e Shkupit në dy anë i takon të kaluarës dhe se politika e tij e veprimet nuk është në drejtim të ndarjes së qytetarëve në vija etnike, fetare apo rajonale.

Apelet e organeve të rendit për kujdesin më të madh gjatë prezencës në komunikacionin rrugor fare pak merren parasysh nga qytetarët. Aksidentet rrugore me pasoja tragjike fatkeqësisht në rrugët e vendit tonë janë një përditshmëri e hidhur. Përveç shpejtësisë së pakontrolluar, ndër shkaqet kryesor se pse ndodhin këto aksidente numërohen edhe mos përfillja e shenjave të komutacionit

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 21 tetor - Kaosi në komunikacion dhe aksidentet rrugor janë pjesë e përditshme e buletinit të Ministrisë për Punë të Brendshme. Kësaj ndodhi edhe fundjavën e kaluar, ku një 38 vjeçar nga Ohri, humbi jetën në aksidentin rrugor që ndodhi në magjistralen Ohër-Kërçovë. Sipas njoftimit zyrtar të MPB-së, ngjarja tragjike ka ndodhur orët e para të 21 tetorit, respektivisht njësitë policor rreth orës 01:25, të ditës së diel kanë pranuar denoncim se magjistralen e apostrofuar ka ndodhur një aksident i rëndë mes kamioni "Mercedes" dhe një veturë "Fiat Punto".

"Në vend ngjarje ka ndërruar jetë personi D.R nga Ohri, i cili ka drejtuar veturën 'Fiat Punto'. Se bashku me të ndjerin në veturë kanë qëndruar edhe bashkudhëtarët L.S, I.R, I.GJ dhe J.K.S, të cilët kanë kaluar me lëndime të rënda trupore. Nga ana tjetër shoferi i 'Mercedesit', 31 vjeçari A.M, po ashtu nga Ohri, ka kaluar vetëm me lën-

UIKENDI LA PAS RRUGË TË PËRGJAKURA



dime të lehta trupore. Kontroll të vendit të ngjarjes po ashtu kanë kryer ekupe të policisë së Ohrit, të udhëhequr përfaqësues të Prokurorisë Publike", thuhet në raportin e policisë. Ashtu siç është praktikë e njohur deri më tani, edhe në këtë rast trupi i të ndjerit me urdhër të prokurorit publike është dërguar për obduksion. Pas përfundimit të hetimeve edhe mbledhjeve të fakteve pritet të vërtetohet se cilat kanë qenë shkaqet kryesor të këtij aksidenti.

Faktin se të gjitha rrugët e Maqedonisë, gjatë vikendit të kaluar u përgjakën e vërteton aksidenti i ndodhur në kryeqytetin ku mes tjerash ka marrë pjesë edhe një veturë me targa të Bosnje dhe Hercegovinës. Polica e Shkupit, duke elaboruar rasti në fjalë sqaron ky aksident ka ndodhur pasi ditën e të

shtunës, rreth orës 13:20, me çka veturën "Shkoda Oktavia" e ka vozitur një 20 vjeçar nga Bosnja.

"Si pasojë e këtij aksidenti me lëndime të rënda ka kaluar shtetasi i BIH, N.M, ndërkaq bashkudhëtarja e tij R.K, 26 vjeçar ka kaluar me lëndime të lehta trupore. Pas kësaj këtij aksidenti të lënduarit nën asistimin e Ndihmës së shpejtë janë dërguar në Qendrën Klinike "Nëna Terezë" për kurim të mëtutjeshëm", theksojnë nga Sektori për Punë të Brendshme, Shkup. Në po të njëjtën ditë, të shtunën e kaluar aksidenti komunikacioni është regjistruar në rrugën rajonale Shkup-Tetovë. Përdallim nga dy rastet e sipërpërmendura ku aksidentet ishin mes veturave dhe një kamioni, në këtë përplasje ka marrë pjesë një veturë dhe një traktor.

"Të dy automjetet kanë qenë me targa të Shkupit, ndërsa aksidenti në aksident kanë marrë pjesë një veturë e lloji 'Audi' e drejtuar nga F.A, 31 vjeçar nga fshati Bukoviq, rrethinë e Tetovës dhe një traktor e drejtuar nga E.J, 55 vjeçar nga fshati Çajlanë, rrethinë e Shkupit. Nga kjo përpalsje me lëndime të rënda ka kaluar shoferi i traktorit, nga fshati Çajlanë dhe i njëjti së bashku me lehtë të lënduarit nga Bukoviqi janë dërguar në spitalin qendror të Shkupit", thonë nga MPB-ja. Ndryshe, muaj më parë rruga rajonale Shkup-Tetovë iu nënshtrua një rikonstruimi të plotë, megjithatë vërejtjet dhe ankesat e banorëve të fshatrave të Dervenit janë se në këtë rrugë mungojnë shenjat e komunikacionit, respektivisht kontrollet e shpeshta të policisë rrugore.



Padi penale ndaj ish zyrtarit

Bashkim Ameti

Shkup, 21 tetor - Ish-drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Bashkimi Ameti, dhe tre punonjës të tjerë kanë marrë kallëzime penale për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe autoritetit. Sipas policisë, të katër këta nuk kanë vepruar pas një aktgjykimi të gjykatës për konfiskimin e pronës dhe kështu e kanë dëmtuar buxhetin e shtetit. Në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2012, i denoncuar/akuzuari i parë dhe e denoncuar e dytë, si menaxherë në Agjencinë për Menaxhimin me pasuritë e Konfiskuara të Republikës së Maqedonisë, i denoncuar/padituri i tretë, si Ndihmës shef i Agjencisë dhe i denoncuar i katërt si Drejtor i Agjencisë, në kundërshtim me Ligjin, nuk kanë vepruar sipas një vendimi gjyqësor për konfiskimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme. – theksuan nga Ministria e Punëve të Brendshme. Sipas Ligjit për Menaxhimin me Pasuri të Konfiskuara, Agjencia me aktgjykim të plotfuqishëm e shet pronën dhe fondet shkojnë në buxhetin e shtetit.

Si do të funksionojë VMRO pas përjashtimit të shtatë anëtarëve?

Shkup, 21 tetor - Shtatë deputet të partisë më të madhe opozitare VMRO, Elizabeta Kanceska Milevska, Emilija Aleksandrova, Nola Ismailovska Starova, Sasho Vasilevski, Luben Arnaudov, Krsto Mukoski dhe Zekir Ranciloviq janë përjashtuar nga partia pasi që kanë votuar pro fillimit të ndryshimeve kushtetuese të parapara në bazë të marrëveshjes për emrin me Greqinë. "Këto shtatë deputet nga VMRO të cilët morën vendim kundërshtues të partisë dhe vullnetit të qytetarëve të Maqedonisë e që ishte poashtu qëndrim partiak në bazë të vendimit të marrë në komitetin ekzekutiv dhe qendrorë dhe në kordinim me grupin parlamentar më kanë zhgënjyer shumë mua por ajo nuk është e rëndësishme shumë sepse para se gjithash kanë zemëruar edhe partinë dhe vendlindjen. Pikërisht për këtë KQ i VMRO-së ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme dhe njëzëri kemi përjashtuar nga partia të shtatë deputetët", ka deklaruar kështu kreu i saj Mickoski. Megjithatë VMRO edhe më parë ka qenë në krizë të thellë por me vendimin e fundit kjo parti vazhdon të jetë e tensionuar dhe nuk dihet ngjarjet që mund të ndodhin më tej tek ajo. Askush nuk ka dilemë se nëse duhet VMRO të qëndrojë në skenën politike ajo duhet seriozisht të reformohet dhe të pastrojë nga themelet shumë punë nga e kaluara e saj.

MPB në mbrojtje të deputetëve të kërcënuar

Shkup, 21 tetor - Tashmë ka nisur një aksion nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme ndaj qytetarëve të cilët nëpër rrjetet sociale facebook dhe twitter kanë komentuar dhe kritikuar e me një fjalë kanë kërcënuar deputetët të cilët kanë votuar pro ndryshimeve kushtetuese.



Me këtë rast, ndaj të me këtë aktivitet do të ndiqet procedurë penale për

kërcënim identiteti dhe prishje imazhi, ofendim dhe shpërndarje të urrejtjes e dhunës psikike.

Ekipet e MPB-së tashmë janë në teren kryesisht në komunën Petrovec dhe Qendër pas paralajmërimeve nga ana e deputetëve Zeqir Ramciloviq dhe Elizabeta Kanceska Milevska.

Struga nikoqire e panairit të ushqimit organik

Bujq, bletarë dhe punonjës turistik të mjediseve rurale në Strugë i prezantuan produktet e tyre në Vevçani në Panairin për ushqim organik "Organike në fushë, tradicionale në tryezë". Panairi është pjesë e projektit "Ferma organike – Kohezion rural për potencial të rritur të turizmit rural dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik rural", të zbatuar nga shoqata Qendra kreative "Rurbankult – Strugë" dhe Shoqata e bletarëve "Matrica 2012". Panairi, siç theksoi koordinatori dhe projektit Zora Klenkoska, e promovoi prodhimin organik të ushqimit

mit të shëndosh dhe ofertën e saj si një produkt tradicional i turizmit rural, gjegjësisht turizmi bujqësor, i cili në mënyrë autentike e verifikon apo e mbush pakon e shërbimeve turistike në mjedisin rural.

Ngjarja, ku përveç vizitorëve nga Struga dhe rrethina kishte mysafirë nga Dibra, Ohri dhe Kavadarë përfundoi me provën e specialiteteve tradicionale delikate të ushqimeve organike të vendit, të përgatitura nga mjeshtrit lokalë ushqimorë. Projekti "Ferma organike – Kohezion rural për potencial të rritur të



turizmit rural dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik rural", mbështetet në kuadër të programit për grante të vogla të projektit "Kuvendi kombëtar rural si zë i popullatës rurale, i miratuar nga CNVP, MRR, e RM-së dhe AkRRA, financuar nga Bashkimi Evropian.

Notat më të dobëta janë fituar në kapacitetin e inovacioneve me 31.1 për qind, madhësinë e tregut me 39.2 për qind, dhe funksionimin e institucioneve me 50.6 për qind.

Koha

Fisnik Pasholli

Shkup, 21 tetor - Maqedonia renditet ndër ekonomitë më të dobëta në Evropë lidhur me konkurrencën e ekonomisë vendore. Sipas raportit për konkurrencë globale, ekonomia e vendit është pozicionuar në vendin e 84-ët duke shënuar rënie prej 22 vendeve në raport me vitin 2016. Më dobët se ne në kontinentin e vjetër, renditet vetëm Mollavia në vendin e 88-të dhe Bosnje e Hercegovina në vendin e 91-të, tregon raporti i fundit i Forumit Ekonomik Botëror që mat konkurrencën e 140 shteteve në botë. Duhet shtuar më tej se Maqedonia si shtet për shkak të mungesës së të dhënave nuk figuron në listën e shteteve konkurruese për vitin 2017. Nga ana tjetër, organizata me bazë në Gjenevë, gjithashtu shtoi disa masa të reja në studimin e saj të vitit 2018, si diversiteti i fuqisë punëtore, liria e shtypit dhe si hierarkitë në kompanitë më të mëdha janë pjesë e një ekonomie të veçantë. Nga ana tjetër edhe pse metodologjia e analizës është tërësisht e re, megjithatë pyetjet lidhur me kriteret janë të njëjtat dhe kanë të bëjnë me produktivitetin, konkurrencën dhe prosperitetin e ekonomisë.

Maqedonia, notat më të mira i ka shënuar në fushën e shëndetësi-

KONKURRENCA E DOBËT E EKONOMISË

MAQEDONIA E FUNDIT NË EVROPË



së me 80 pikë nga 100 të mundshme, stabilitetin makroekonomik ku ka fituar 74.6 pikë dhe dinamizmin në biznes ku ka fituar 61.2 pikë.

KAPACITETI I INOVACIONEVE, ME PERFORMANCË TË ULËT

Notat më të dobëta janë fituar në kapacitetin e inovacioneve me 31.1 për qind, madhësinë e tregut me 39.2 për qind, dhe funksionimin e institucioneve me 50.6 për qind.

Të dhënat bazohen në perceptimin e menaxherëve kryesor të kompanive si dhe statistikave të institucioneve shtetërore që tregojnë një listë të gjërë të fushave që shënojnë rënie në raport me vitin 2016. Më dobët si shtet në suaza globale jemi të renditur në pjesën e gjyqësorit, tregjet ku bizneset pak kanë qasje dhe në infrastrukturë.

Notat e dobëta në raport kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e dobët të pronësisë intelektuale dhe fizike, si dhe joefikasitetin e ligjeve. Në renditjen e dobët ka ndikuar ndër-

lidhja dhe cilësia e rrugëve apo shërbimet e hekurudhës. Të ankuarit janë ankuar se mjaft vështirë mund të gjejnë punëtorë të kualifikuar, se ekziston bashkëpunimi i vogël i pronarëve të bizneseve me sindikatat dhe se rrallë praktikohet trajnimi i kuadrit të nevojshëm.

Lidhur me arsimin dhe shkathtësive të punëtorëve, Maqedonia gjendet në vendin e 81-të në botë, mirëpo vendi i 130-të i cilësisë së arsimit profesional, tregon se me çfarë mungese të fuqisë punëtore ballafaqohet tregu i punës.

Nga shtetet e tjera të rajonit, Kroacia shënon rënie nga vendi i 66 në vendin e 68-të, Mali i zi ka avancuar dy vende duke u renditur në vendin e 71-të, ndërsa Shqipëria renditet në vendin e 76-të në botë duke shënuar përparim për katër vende në listë në raport me vitin paraprak kur ka qenë e 80-ta në listë. Përparim shënon edhe Serbia nga vendi i 70-të në vendin e 65-të.

Bosnje e Hercegovina me vendin 91-të renditet për një bend më

dobët se vitin paraprak dhe është ekonomia pak konkurruese në rajon. Sllovenia vazhdon të mbajë vendin e 35-të në botë. Nga shtetet e tjera të rajonit anëtare të BE-së, me të cilat shpesh krahasohemi Bullgaria renditet në vendin e 51-të, ndërsa Rumunia në vendin e 52-të. Në krye të raportit për konkurrencë globale janë SHBA-të, Singapori dhe Gjermania.

PRODUKTIVITETI, PËRCAKTUESI RITJES SË ARDHURAVE AFATGJATA

Më tej analizat tregojnë se Evropa ishte më pak konkurruese se Azia Lindore dhe rajonet e paqësorit. Gjithashtu, theksohet se shumica e ekonomive globale ishin të përgatitura keq për përparimet e shpejta në teknologji. VEF vlerëson ekonomitë më të mëdha të botës në pothuajse 100 tregues të ndryshëm, që nga cilësia e infrastrukturës e deri në jetëgjatësinë dhe në tregun e punës.

Studimi i paraqet një ndër-

vlerësimet më të plota dhe komplekse të ekonomive kombëtare.

Në përmbledhje, në mes të ndryshimeve të shpejta teknologjike, politike dhe një rimëkëmbje e brishtë ekonomike, është kritike që ne të përcaktojmë, vlerësojmë dhe zbatojmë rrugë të reja

për rritjen dhe prosperitetin. Produktiviteti është më së shumti përcaktues i rëndësishëm i rritjes dhe të ardhurave afatgjata dhe është në qendër të analizës.

Edicioni 2018 i Raportit të Konkurrencës Globale paraqet një moment historik në historinë e katër dekadave, me futjen e Indeksit të ri të Konkurrueshmërisë Globale 4.0. Indeksi i ri hedh dritë mbi një grup në rritje të drejtuesve të produktivitetit dhe rritjes afatgjatë në epokën e Revolucionit të Katërt Industrial. Ai siguron një busull shumë të nevojshëm për politikëbërësit dhe palët e tjera të grupit të interesit për të ndihmuar në hartimin e strategjive ekonomike dhe monitorimin e progresit.

Maqedonia vitin e kaluar, përkatësisht 2017 e mbylli me një rritje ekonomike vetëm prej 0.1 për qind. Afaristët thonë se më shpresëdhënëse për rritjen ekonomike mund të jetë pjesa e dytë e 2019-ës pasi vendi të arrijë të anëtarësohet në NATO

Shkup, 21 tetor - Afaristët në Maqedoni thonë se proceset që ndërlihen me rrumbullaksimin e Marrëveshjes me Greqinë duhet të realizohen me një dinamikë sa më intensive, duke përhëndetur votimin e fazës së parë për ndryshimet kushtetuese si pjesë e marrëveshjes së Prespës, në të kundërtën drujnë se pasiguria politike do të vazhdojë të ulë projektionet e organizatave

AFARISTËT ME SHQETËSIME KONKRETE

RRITJA EKONOMIKE, PENG I PAQARTËSIVE POLITIKE

ndërkombëtare sa i përket zhvillimit ekonomik.

Ndërkohë, që Qeveria e Maqedonisë mbetet optimiste se deri në fund të vitit, zhvillimi ekonomik megjithatë do të arrijë në 3.2 për qind në bazë të parashikimeve, Fondi Monetar Ndërkombëtar gjatë këtij viti dy herë me radhë ka zvogëluar parashikimet për rritjen ekonomike të Maqedonisë. Së fundmi, sipas parashikimeve të FMN-së, rritja ekonomike në Maqedoni do të arrijë në vetëm 1.6 për qind.

Menderes Kuçi, afarist, për Radion Evropë e lirë thotë se "paqartësitë politike" pas referendumit dhe i tërë fokusimi i qeverisë për t'i zgjidhur ato, e ka lënë në hije zhvillimin e ekonomisë duke e çuar pothuajse kah paralizimi. Kuçi thotë se zhvillimet pas referendumit dhe paqartësitë në këtë drejtim pas pritjeve që të zhbllokohet

procesi i integritetit të Maqedonisë në strukturat euroatlantike e bëjnë shumë të ndjeshëm zhvillimin ekonomik, përkatësisht në këtë situatë, thotë ai, askush nuk merr guximin të investojë, as kompanitë e huaja por as ato të vendit.

"Në këso situatë, apo klimë politike ku qeveria është fokusuar tërësisht në çështjet politike, mund të ndodh që projektionet e Fondit Monetar Ndërkombëtarë mund të mos realizohen për shkak të ngecjeve sa u përket investimeve kapitale. Ne si afaristë konsiderojmë se më reale është parashikimi që rritja ekonomike të jetë diçka mbi zero, megjithëse do të ishim shumë të kënaqur nëse realizohen parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtarë që rritja ekonomike të arrijë shkallën 1.6 për qind", vlerëson Menderes Kuçi, afarist.

Nga ana tjetër, Alaudin Zeqiri,

ligjërues në fakultetin ekonomik në Universitetin e Tetovës, për Radion Evropë e Lirë thotë se "mungesa e stabilitetit politik ka efekte negative që ndërlihen drejtpërdrejt në rritjen ekonomike të shtetit.

Zeqiri sqaron masat e ndërmarra nga qeveria për mëkëmbjen e ekonomisë nuk prodhojnë efekte pozitive përderisa ekonomia mbetet nën ethe dhe paqëndrueshmërisë politike si rrjedhojë e paralajmërimeve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare si mundësi për të zgjidhur ngërçin politik.

"Ne patëm një cikël të votimit për çështjen e referendumit, që situatën pas e ka vënë në "Stand by". Informacionet spekuluese për realizimin eventual të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare gjithsesi se kanë efekt negativ kundrejt rritjes ekonomike, pra

projeksionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar tani ulen në 1.6 për qind. Zhvillimet politike do të diktojnë situatën ekonomike se a do të vazhdojë ulja e projektioneve edhe më tej sa i përket zhvillimit ekonomik", thotë Zeqiri.

Ndryshe, Maqedonia vitin e kaluar, përkatësisht 2017 e mbylli me një rritje ekonomike vetëm prej 0.1 për qind. Afaristët thonë se më shpresëdhënëse për rritjen ekonomike mund të jetë pjesa e dytë e 2019-ës pasi vendi të arrijë të anëtarësohet në NATO. Edhe kundrejt kësaj, kreu i qeverisë Zoran Zaev ka theksuar se është optimist sa i përket realizimit të rritjes së projektuar nga Qeveria e Maqedonisë prej mbi 3.2 për qind. Por, sipas parashikimeve të FMN-së, Maqedonia radhitet e fundit në listën e vendeve të rajonit sa i përket rritjes ekonomike. (Evropa e Lirë)



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHALLJE PUBLIKE NUMËR – 233/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Institucionin publik Parkun Nacional Galjiçica - Ohër “për vendet e punës në vijim:

1. NAP0102B04001 Udhëheqës i njësive për punë të përgjithshme, juridike dhe ekonomike 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Kushtet shtesë:

- Vërtetim për provim të dhënë për furnizime publike
- Vërtetim për provim të dhënë të jurisprudencës

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:00 - 15:00
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 31.500,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. NAP0102G01003 Referent i pavarur - magazinier, Njësia për punë të përgjithshme, juridike dhe ekonomike 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:00 - 15:00
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 23.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësimit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 68 paragrafi 2 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, dhe nenin 154 paragrafi 3 alineja 2 e Ligjit për të drejtat e fëmijëve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 148/13), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 18 Tetor 2018, solli

VENDIM PËR PUBLIKIM TË SHPALLJES PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË ANËTARIT TË KËSHILLIT SHTETËROR PËR PARANDALIM TË DELIKUENCËS FËMIJËRORE

1. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë shpall se do të bëhet zgjedhje të anëtarit të Këshillit shtetëror për parandalim të delikucencës fëmijërore.

2. Kandidatët e interesuar, shtetas të Republikës së Maqedonisë nga radhët e organizatave joqeveritare për mbrojtjen e fëmijëve në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të parashtrajnë: Fletëparaqitje, biografine dhe dokumentet, me të cilët konfirmohet se janë shtetas të Republikës së Maqedonisë, punëtorë të theksuar për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe se janë përfaqësues të organizatave joqeveritare për mbrojtje të fëmijëve.

3. Ky vendim do të publikohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe në gazetata „Nova Makedonija”, „Sloboden Peçat” dhe „Koha”.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 08 - 6030/1

18 tetor 2018

Shkup

KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

M-r Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

ZËVENDËSSEKRETARI GJENERAL I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Nexhbedin Ibraimi

Në bazë të nenit 68 paragrafi 2 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 15 paragrafi (1) dhe neni 16 paragrafi (1) nga Ligji për përcjelljen e komunikimeve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 18 tetor 2018, solli

VENDIM PËR PUBLIKIM TË SHPALLJES PUBLIKE PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË AGJENCIONIT PËR KOMUNIKIME ELEKTRONIKE

I. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikon shpallje publike për emërim të dy anëtarëve të Komisionit të Agjencionit për komunikime elektronike (në tekstin e më tejshëm:Komisioni)

II.Për anëtarë të komisionit mund të emërohet person, i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënime ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

- në mënyrë aktive ta shfrytëzojë gjuhën maqedone
- ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK, gjegjësisht shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit në sferat e informatikës, telekomunikimit, juridike ose ekonomike
- ka minimum pesë vjet përvojë pune përkatëse dhe njohuri të posaçme nga sfera e komunikimit elektronik dhe

- posedon certifikatë për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyre

III. Kandidatët e interesuar fletëparaqitjet për pjesëmarrje në këtë shpallje, biografina personale dhe dokumentet e nevojshme me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve nga pika II e këtij vendimi, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, mund ti t'i parashtrajnë deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

IV. Ky vendim do të publikohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe në gazetata „Nova Makedonija”, „Sloboden Peçat” dhe „Koha”.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 08 - 6032/1

18 tetor 2018

Shkup

KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

M-r Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

ZËVENDËSSEKRETARI GJENERAL I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Nexhbedin Ibraimi

GJERMANIA BËN "PAZAR" NË SHQIPËRI

DERI NË 2060, NEVOJITEN 17 MILIONË PROFESIONISTË

Vlerësohet se, Gjermanisë i nevojitet një emigracion neto prej 400 mijë emigrantësh në vit, deri në vitin 2060, në mënyrë që të mbulojë 'vrimat' në tregun e punës, e sidomos për punët që kanë nevojë për kualifikime. Kjo përkthehet në rreth 17 milionë emigrantë në harkun e 42 viteve të ardhshme.

Nga Roel Korkuti



për të huajt që duan të punojnë në sektorin e kujdesit shëndetësor në Gjermani. Në 15 vitet e ardhshme, projektohet që sektori të ketë një mungesë prej 250 mijë profesionistësh. Vetëm emigrantët mund ta mbulojnë këtë hendek. Të dhënat e Urdhrit të Mjekut flasin mesatarisht për 150 kërkesa në vit nga mjekët shqiptarë për t'u larguar drejt Gjermanisë, çka bën që në 4 vitet e fundit të jenë larguar mbi 500 mjekë. Për infermierët, ndërkohë, numri është bindshëm më i lartë, pasi flitet për rreth 3000 të larguar.

Kjo tendencë mund të rritet edhe më shumë me ligjin e ri gjerman dhe nevojën në rritje për profesionistë. As politikat e reja të qeverisë shqiptare për të stimuluar ekonomikisht mjekët që punojnë në rrethe, nuk kanë pasur efekt në zhbërjen e dëshirës për t'u larguar nga vendi.

DEBATET PËR LIGJIN E RI

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, po vendos kështu një bast mjaft të rrezikshëm, në një kohë aspak të lehtë për të. Pas një viti mjaft të vështirë, si pasojë e negociatave për formimin e qeverisë, por edhe si pasojë e presioneve të brendshme nga forcat konservatore, Angela Merkel guxon sërish, pikërisht atje ku askush nuk do të guxonte, pasi po i jep ushqim populistëve dhe forcave antiemigrante.

Por, mesa duket, qeveria e drejtuar nga Merkel i ka idetë e qarta; bomba demografike që është duke shpërthyer në Gjermani, mund të çmontohet vetëm nga të huajt. Zgjidhje tjetër, sipas tyre, nuk ka. Ligji i ri ka për qëllim të tërheqë punonjësit jashtë Bashkimit Europian, paçka se iu duhet një kualifikim profesional si dhe gjuha gjermane, kur të aplikojnë për vizë, sipas projektligjit. Zyrtarët e lartë gjermanë e shohin këtë ligj si diçka që do të ndryshojë tërësisht "lojën", në garën globale të tërheqjes së talenteve, në një kohë që shumë shtete të botës po vendosin rregulla të ashpra kundër emigrantëve. Por, nga ana tjetër, ky ligj i ri mund të zemërojë elektoratin, që tashmë ndihet i lënë pas dore nga kancelarja dhe nga vendimi i saj për të hapur dyert ndaj më shumë se një milion refugjatëve që prej vitit 2015. Një sondazh i zhvilluar së fundmi tregon se, 51% e gjermanëve mendojnë se qeveria e tyre nuk e merr seriozisht problemin e emigracionit. Në Gjermaninë Lindore, ndërkohë, kjo normë ngjitet në 66%. Vitin e

ardhshëm, në pjesën dërrmuese të rajoneve lindore të vendit, si në Saksoni, Brandenburg, etj, do të mbahen zgjedhjet lokale.

Në këto zona, e djathta ekstreme, që tanimë në Gjermani mban emrin "Alternativa për Gjermaninë", pritet që të fitojë shumicën në kurrizin e konservatorëve të Angela Merkel dhe të socialdemokratëve, të cilët duket se kanë dalë nga skena vendimmarrëse. "Alternativa për Gjermaninë" e kundërshton ashpër ligjin e ri. Ndarjet e thella në vend janë bërë të dukshme gjatë muajve të fundit, me protesta tashmë edhe të dhunshme nga grupimet kundër emigrantëve.

MISIONI I PAMUNDUR I MERKEL

"Emigrimi është 'nëna' e të gjithë problemeve politike në Gjermani", deklaroi ministri i Brendshëm, Horst Seehofer, i cili është edhe kreu i partisë simotër të Merkel, Unioni Kristian Social. Merkel, ndërkohë, ka përdetyrë që të bindë elektoratin se ligji i ri është i pashmangshëm dhe mjaft i domosdoshëm për të mbuluar hendeqet në tregun e punës. Merkel, nga ana tjetër, duhet të bindë gjermanët se ky ligj nuk do të rrisë konkurrencën në tregun e punës. Vendasit i tremben mjaftueshëm idesë se të huajt do t'u vjedhin atyre vendet e punës. Kjo frikë buron edhe nga propaganda e partive populiste, antiemigracion. "Nëse Merkel do të arrijë që në mënyrë të besueshme të bindë njerëzit se kjo po bëhet në të mirën e përbashkët të vendit, atëherë nuk do të ketë zemëratë mes atyre që janë prej kohësh të zemëruar me këto lloj politikash. Por, në të kundërt, ky ligj do të kthehet kundër Angela Merkel, po të kemi parasysh se vitin e ardhshëm janë tre palë zgjedhesh lokale në Gjermaninë Lindore. Zgjedhje lokale ka edhe këtë vit në Bavari dhe Hesse, ku "Alternativa për Gjermaninë" duket se po rrit ndjeshëm pozitat e saj dhe frikëson çdo ditë e më shumë. Pra, Angela Merkel rrezikon shumë, edhe pse qëllimi i saj i vetëm është që të shmangë tragjedinë, pasi është pikërisht ky, fundi i ekonomisë më të madhe të Europës, në rast se nuk do të marrë masa sot.

GJERMANISË I DUHEN 400 MIJË EMIGRANTË NË VIT

Vlerësohet se, Gjermanisë i nevojitet një emigracion neto prej 400 mijë emigrantësh në vit, deri në vitin 2060, në mënyrë që të mbulojë 'vrimat' në tregun e punës, e sidomos

pagave për punonjësit lokalë dhe më pak të kualifikuar.

REFUGJATËT E 2015-ËS E KANË TË VËSHITIRË TË GJEJNË PUNË

Një tjetër problem për refugjatët është ai i gjetjes së një vendi pune. Një refugjat i ardhur nga Afganistani apo Siria në vitin 2015 e ka mjaft të vështirë të gjejë një vend pune, për shkak të mungesës së kualifikimeve dhe edukimit të dobët.

Një refugjati të tillë i duhen 3 deri në 5 vite për të marrë një kualifikim profesional. Ligjëbërësit, ndërkohë, vazhdojnë edhe debatet nëse refugjatët që gjejnë një punë dhe që mësojnë gjuhën gjermane duhet të përfitojnë apo jo nga statusi i azilantit. Konservatorët shprehen se, kjo nxit ardhjen e më shumë refugjatëve me aftësi profesionale të dobëta. Të dhënat tregojnë se, Gjermania është vendi i dytë në botë më i preferuar për emigrantët, pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në këtë tendencë ka pasur një ndikim thelbësor edhe politika e detyrë të hapura e Angela Merkel. Madje, Gjermania është vendi më i preferuar edhe mes shteteve europiane. Më shumë se gjysma e emigrantëve që kanë hyrë në vend në 2016-ën vinin pikërisht nga një prej vendeve anëtare të unionit, të cilët shfrytëzojnë mungesën e barrierave për të lëvizur dhe punuar si dhe ofertën e lartë në tregun e punës në Gjermani. Të njëjtën gjë që po bëjnë edhe shqiptarët prej vitesh.

GJERMANIA, "PAZAR" NË SHQIPËRI

Por, shqiptarët ndryshe nga europianët e kanë më të vështirë për të rregulluar dokumentet, pavarësisht se me një kualifikim të duhur, e sidomos me gjuhën në xhep është shumë e kollajtë. Gjithsesi, burokracitë janë të mëdha. Tendencën e shqiptarëve të kualifikuar për t'u futur në tregun gjerman të punës si dhe tendencën e Gjermanisë për të "bërë pazar" në tregun shqiptar të forcës punëtore e vërtetojnë edhe tendencat më të fundit për të mësuar gjuhën gjermane.

Madje, si për ironi të fatit, një ndër degët më të suksesshme të arsimit profesional, të trumbetuar me jehonë të madhe nga qeveria, rezultoi të jetë pikërisht ajo e gjuhëve të huaja. E mes këtyre gjuhëve të huaja, patjetër që gjuha gjermane është më e preferuara. Shqiptarët sot po mësojnë masivisht gjermanishten, e këtë e vërtetojnë jo vetëm shifrat e arsimit profesional, shifrat e kurseve të gjuhës, por edhe ato të aplikacioneve "online" apo në aparatet celularë. Këto të fundit tregojnë se shqiptarët janë duke mësuar gjermanisht. Gjuhë kjo tërësisht dytësore deri pak vite më parë, kur mbizotëronin gjuhë si anglisht, italisht apo frëngjisht. Ndër të tjera, qeveria gjermane është ndër mbështetëset dhe financueset kryesore të zhvillimit të arsimit profesional në vendin tonë, gjatë viteve të fundit./SCAN Magazine.

Vret një dhe quhesh 'vrasës', vret shumë e quhesh 'sfidant'



Nga
Aurora Karameti

E thet e së premtes këtë herë na dolën për mirë. Përfaqësuesit e popullit në kuvend e treguan përfundimisht se kush e do dhe kush nuk e do vërtet Maqedoninë. Shqiptarët, të gjithë pa përjashtim vërtetuan se janë për ekzistencën e këtij shteti si pjesë e aleancave perëndimore. Partia social-demokrate gjithashtu. Përfaqësuesit e VMRO-së e treguan se janë veçse një organizatë me qëllime terroriste dhe anarshiste, që merret me politikë. Këtë e treguan edhe me votat « kundër » edhe me votat « për ». Kjo parti as që ka vizion për shtetin. Para zgjedhjeve punonte vetëm për tu pasuruar ; pas zgjedhjeve punon vetëm për ta ruajtur pasurinë, jashtë hekurave të burgjeve.

Ata deputetë të Vmro-së që të premten votuan pro gjithësi i përgëzoj, sepse votat e tyre zhbllokuan situatën. Por nga ana tjetër, simpatizantët e verbër Vmro-istë le ta kuptojnë se katër deputetët e liruar nga burgjet votuan vetëm për të shpëtuar lëkurën e tyre, vetëm për tu liruar nga akuzat për terrorizëm dhe krime të tjera. Pra, ata ishin me Vmro-në për interesa dhe u kthyen me Lsdm-në përsëri për interesa personale. Po sikur të gjithë deputetët e Vmro-së që kanë abuzuar me pushtetin të kishin qenë nëpër burgje para seancës plenare për ndryshimet kushtetuese ? Nëse edhe atyre do tu ishte ofruar « pajtim » apo amnisti, të gjithë do të kishin votuar pro. Në atë rast nuk do arrihej vetëm limiti prej 80 votash por do te kishim një parlament me shumicë pro ndryshimeve kushtetuese, pro marrëveshjes së Prespës, pro NATO-s.

Popull përkrahës i Vmro-së, këta katër deputetë që kaluan në anën e kryeministrit Zaev, me hir apo pahir, dikur për partinë tuaj ishin heroj, sot janë tradhtarë...Dikur jo larg, por vetëm një vit më parë deputetët e votuar nga ju hapën dyert e parlamentit për huliganë të porositur që çuan pranë vdekjes një deputet shqiptar, që gjakosën kryeministrin e sotëm, tërhoqën për flokësh ministrin e sotme të mbrojtjes, rrahën, terrorizuan dhe shkatërruan e turpëruan

tempullin e demokracisë. Ish ministrja fashion e kulturës mban mbi supe akuza të rënda për krime ekonomike. Por ja, të premten e bardhë të datës 19 tetor ata u falenderuan nga Zaevi se « vendosën mbi interesin partiak dhe personal, dhe kaluan në anën e interesit shtetëror » dhe u quajtën « heronj ». Në fakt, ata nuk do ta kishin bërë këtë për interesin e përgjithshëm të shtetit , nëse nuk do të ishin nën akuza nga prokuroria speciale për vepra penale aq të rënda si për shembull terrorizmi...! Tani me siguri edhe Gruevski është duke ua lakmuar situatën këtyre katër kriminelëve-heronj. Ah sikur Zaev ti kishte kërkuar edhe atij një votë dhe ta amnistonte ! Edhe politikan miliarder, edhe hero do ishte!

Sigurisht që liria e katër kriminelëve nuk vlen aq shumë sa anëtarësimi në NATO, thënë

thjeshtë ! Por a mos jemi duke jetuar klimaksin e degradimit të sistemit të drejtësisë në Maqedoni ? Dëshirën e mirë të Zaevit për të bërë politikë progresiste të pajtimit mbi interesat partiake dhe revansizmat ordinere e kuptoj shumë mirë dhe e justifikoj, nisur nga qëllimet madhore të një shteti të ngecur si ne. Por mos jemi duke parë skena të gjalla si nga filmi Cliffhanger ? Po, disa i pamë dhe i përjetuam gjatë përpjekjeve për mbijetesë nën rregjimin fashist të VMRO-se ku njeriu dënohej me burg se vidhte një bukë por sot, në mënyrë spektakolare po shohim si po lirohen nga burgu kriminelët e kalibrit të lartë, madje me ofertë nga shefi i qeverisë për pajtim! Kryeministrit Zaev i lutem publikisht të mos na bëjë të besojmë skenën e filmit ku përdoret thënia e shkrimtarit francez Jean Rostand « Vret një njeri dhe te quajnë vrasës,

Lëreni VMRO-në të shkatërrohet si parti por pa rehabilituar individët. Kaq shumë vite kriminalitet nuk mund të shpaguhet edhe nëse ju e dëshironi ta bëni këtë gjë, ndoshta sepse ata sidoqoftë janë maqedonas, janë tuajët. Mos vrisni besimin e pjesës së ndershme të popullsisë tek drejtësia dhe mos krijoni precedentë të frikshëm. Tani që NATO-n e kemi të sigurt, punoni edhe për të na siguruar rend dhe zbatim të ligjit brenda vendit.



vret shume njerëz dhe të quajnë sfidant, i vret të gjithë dhe bëhesh zot ». Tani shteti do tu ofrojë mbrojtje këtyre terroristeve të djeshëm sepse sot na u bënë heronj meqë na dhanë një votë. Dmth. ata që na mbajtën jashtë Nato-s dhe BE-së me dekada, në vend që të paguajnë dëmet dhe të kthejnë paratë e vjedhura nga buxheti i shtetit, na vënë në pozicion tu themi 'falemnderit që s'po na pengoni më' dhe tu sigurojmë mbrojtje shtetërore! Ndërsa ne që nuk vodhëm, nuk bëmë krime, që hoqëm në kurriz vuajtjet që na shkaktoi ai sistem si edhe që bëmë çmos që ai sistem të binte, jo vetëm që nuk kemi mbrojtje nga shteti, por do i kemi përsëri të lirë vërdallë këta sfidantët që në pushtet ishin dje dhe me pushtetin janë sot ! Dhunuesit e banesës sime para disa vitesh nuk u gjenden kurrë nga policia. Mos ndoshta siguria ime dhe e gjithë atyre si

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 21 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

unë nuk vlen aq sa siguria e deputetëve maqedonas Vmro-istë?

Partia e këtyre « heronjve » të sotëm, gjatë dekadës së kaluar ka bërë në Maqedoni akte të absurdit ekstrem, të nivelit të definuar nga Rostand në gjysmën e parë të shekullit XX. Vrau me politiken antinjerëzore a sidomos antishqiptare dhe madje pushtetin e pakufizuar na e përplaste në fytyrë me gjakftohtësi ironike, dënoi dhe futi nëpër burgje njerëz të pafajshëm dhe shkatërroi jetën dhe të ardhmen e gati një milion njerëzve që ishin jo-Vmro. Ajo parti punonte si një bandë. Ata ishin madje të admiruar nga përkrahësit e tyre si 'shumë të aftë t'ua tregojnë vendin shqiptarëve', ishin të paprekshëm dhe madje arritën të pasurohen me shumë sesa po të kishin biznese në Amerikë...

Gruevski i pashkolluar arriti të bëhej idhull i shumë gjysmakëve të frustruar që e shihnin atë si model suksesi. Arriti të vriste vlerat, drejtësinë dhe madje moralin në masë të madhe por, falë Zotit jo të gjithë, e të bëhej zot! E kjo jo për meritën tonë por për meritën a ndërkombehtarëve. Sidoqoftë, këto dëme morale si edhe qindra milionat e vjedhura do të duhet përsëri ti paguajnë jo-heronjtë. Prandaj, z. kryeministër, mos i ktheni kriminelët në « të dashur deputetë » - sfidantë të sistemit të drejtësisë në Maqedoni. Z. kryeministër, mos vërtetoni edhe ju se në këtë vend kriminelit me pushtet vlen më shumë sesa qytetari i ndershëm pa pushtet. Bëtë mirë që u ofruat kompromis por mos u jepni më shumë se kaq, mjaft!

Lëreni VMRO-në të shkatërrohet si parti por pa rehabilituar individët. Kaq shumë vite kriminalitet nuk mund të shpaguehen edhe nëse ju e dëshironi ta bëni këtë gjë, ndoshta sepse ata sidoqoftë janë maqedonas, janë tuajët. Mos vrisni besimin e pjesës së ndershme të popullsisë tek drejtësia dhe mos krijoni precedentë të frikshëm. Tani që NATO-n e kemi të sigurt, punoni edhe për të na siguruar rend dhe zbatim të ligjit brenda vendit.

FORTUNA E FJALËS SË GODITUR NË REALITETIN E KOHËS


Nga
Remzi SALIHU

(Laureat i FNP "Ditëve e Naimit" 2018)

Poeti Beat Brehbyl u lind më 1939 në Oppligen afër kryeqytetit zviceran, Bern. Vitet e fëmijërisë i kaloi në Nidervitrach të kantonit të Bernës. Absolvoi si radhitës i shkronjave në Bern. Nga viti 1960 filloj të punoj në radhitjen e librave në Zhenevë. Gjatë asaj kohe ndoqi shumë kurse për fotografi dhe tipografi. Nga viti 1961 deri më 1964 u bë redaktor i revistës "ciou". Pastaj pas vitit 1964 deri 1965 përsëri bëhet radhitës në Berlin dhe Cyrih. Pas vitit 1966 punësohet në shtëpinë Botuese Diogen të Cyrichut. Kurse që nga viti 1971 vepron si grafist dhe shkrimtar i lirë. Më 1980 themelon shtëpinë botuese Valdung në Frauenfeld. Këtu udhëheq shtëpinë botuese dhe atelien Botoni. Poeti Beat Brehbyl tani jeton në Frauenfeld. Shkruan lirika, prozë për fëmijë dhe të rritur. Është anëtar i PEN qendrës, ku edhe ka qenë kryetar i saj gjatë viteve 1991-1999. Për punën e tij kreative është shpërblyer shumë herë në Zvicër dhe jashtë vendit.

Autor shumë dimenzional

Pra, poeti Beat Brehbyl është autor zviceran shumë dimenzional. Rrugëtimi i tij kreativ kap hapësira të shumta dhe të ndjeshme njerëzore, ku me një zhdërvjelltësi kreative skicohet e rrëfëhet jeta dhe marrëdhëniet e njeriut me natyrën dhe me shumë ndodhi tjera të përditshmërisë. Poeti është një lirik i spikatur, me veçanti perceptimi të theksuar intimiteti, që e dallon theksueshëm atë shprehjen e tij poetike, prej shumë autorëve tjerë bashkëkohorë. Gjuha poetike e këtij poeti flet më shumë se gjuha e përditshmërisë së bisedës. Sepse poeti është gjithnjë në kërkim të fjalës së goditur dhe të asaj gjendje, situatë të përjetuar nga vetja dhe të tjerët. Në vargjet e tij ndeshet një ylber ngjyrash të shumta motive, nëpër të cilat ngjyra kolorite të fjalëve, kalëron edhe e përhirta e arsyeshme dhe sidomos ajo jeta intime e individit, e përballur me botën dhe teknikën bashkëkohore që na rrethon. Lëvizjet dhe shëtitjet e tij të përhershme kreative i bën duke kërkuar shprehjen tipike moderne të kohës. Shprehjet dhe fjalët e kërkuara me kujdes vijin nga frymëzimet tipike të përjetimeve të shumta jetësore. Këto përjetime të dala nga shtigjet e njohura artistike, janë gjurmë të veçanta, që i ka të salduara mjeshtërisht nëpër vargje. Si duket poeti performon në



vargje atë kërkesë njerëzore të brendshme që nuk mund ta shfaq hapur lirshëm nëpër situatë të caktuara ndeshesh e takimesh njerëzore. Imagjinata krijuese e autorit rrëzon kufizime lirish e ndalesash, ajo kureshtja e tij këmbëngulëse, për ta njohur botën dhe gjërat rreth tij, e lidh thellësinë e mendimit dhe provokimit artistik nëpër situatë të pa thyeshme të qëndresës dhe vetëbesimit. Për poetin jeta si në përfundim jug apo lindje është e njëjtë. Njeriun dhe brendinë e tij e percepton përmes kuptimit të shpirtit dhe arsyes që ka, e cila arsye është e lidhur me emocione të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Pos kësaj autori jep imazhe dhe sentenca poetike ku njeriu është i lidhur me botën industriale dhe nga ambienti që e rrethon. Metaforat e tij janë turbina kryesore e imagjinatës së tij reflektive. Autori na sjell fotografi jetësore, përshtypje, apo ndikime të shumta, ku gërshetohet e kaluara dhe e ardhmja e jetës njerëzore dhe shoqërore.

Beat Brehbyl në gjykimin e tij poetik kërkon shkakun dhe jo pasojën. Kryesisht kërkon rrënjën e problemit brenda ndodhive që veprojnë në jetën e përditshme. Lirika

e tij duhet të vërehet e dëgjohet me një vëmendje të posaçme për të kuptuar thellësinë dhe mesazhin e saj dedikues. Çdo varg ka kuptim dimenzional alternativ interpretimi. Sepse fjalët e tij kumbojnë në kuptim të domethënies zhurmuese që të lënë përshtypje gjatë leximit të vëmendshëm të tyre. Nëpër shumë poezi na duket se autori na grish për gjërat që i kemi të njohura edhe ne në jetë në tonë, por ato bëhen më të kuptueshme kur lexohen këto vargje me vëmendje.

Poeti nuk do poezinë vetëm për ta shkruar sa për sy e faqe

Kryesisht poezitë e Brehbylit na mësojnë për të kuptuar fshehtësitë e dashurisë në jetën e mistershme të njeriut, e cila jetë padyshim në botën e saj të brendshme ka të strehuar të bukurën dhe të shëmtuarën, por edhe brengën e saj që mbështjelllet rreth këtij fenomeni kaq të madh dhe sublim. Kur i lexojmë këto vargje që kanë mesazh, na duket se edhe ne jemi bashkudhëtar i tij dhe posaçërisht me ato gjëra perceptuese që na jepin për synim në realitetin e kohës.

Përmbledhja poetike "Gedichte fur Frauen und Balsaminen", dhe shqip të përkthyer nga Ferdinand Laholli "Poezi për gratë

dhe lulet mosmëprek", që unë do ta kisha përkthyer "Poezi për gratë dhe lulenishte, ose lule ballsamet" (sepse Ballsam-është lëng i trashë si i rrëshirë, me erë të mirë, që kullon nga disa drurë që përdoret në teknikë dhe mjekësi. Mjet që zbut a qetëson dhembjen, ngushëllim, balsamimi i kufomës, etj) Sepse ky titull i dhënë kështu ka të bëjë me vet përjasjen dhe sprovën e autorit në preokupimin e tij artistik. Këto dy faktorë ngjizen figurativisht nën vetëdije me nisjen e kërkimit të momentit adekuat të dashurisë. Sepse sipas autorit askush nuk e di saktësisht kur vjen ai pikëtakimi i pëlqimit, apo moment të dashurisë, që na befason dhe vjen si "rrufeja" gjatë jetës dhe veprimit të përditshëm. Çdo synim ka esencën e vet, që ngjall dëshirën dhe epushin njerëzor, e cila madje bëhet rrjetë që të mban peng vardisjesh të pa frenuara nëpër kohë. Poeti nuk do poezinë vetëm për ta shkruar sa për sy e faqe dhe për të marshuar në "shkopin e taktit" të famës, por do me një vëmendje të posaçme, atë poezi që ulet bashkë me ne, apo siç thotë në një rast poeti poezi që ulet në "tavolinë me mua" dhe që mua më largon nga vetja. Poeti po ashtu pranon ato poezi që janë më "punëtore se politikanët" dhe sidomos ato poezi që janë të pa përkulshme nëpër betejat të shumta jetësore.

Përkushtimi i përhershëm i poeti në kërkimin e fjalëve të reja dhe të veçanta na duket se janë shigjeta thumbuese antiformaliste. Nuk i jep shumë rëndësi forms. Por edhe pse poeti mendon kështu për trajtimin e poezisë, aty kah vitet 1982 dhe 1988, na befason me dy përmbledhje Haiku, ku me shkathtësi krijuese shëmbëllen kujdesshëm me tri vargëshin e poezisë së shkurtë, kryesisht të formuar nga 17 rrokje. Në vargun e parë gjenden 5 rrokje, 7 në vargun e dytë, kurse 5 rrokje në vargun e tretë. Poeti kësaj here i ka qëndruar besnik formës së teknike të të shkruarit konciz.

Por sidoqoftë nga kjo prani e artit të kultivuar, poeti Beat Brehbyl, ka bërë emër të veçantë në poezinë bashkëkohore me vargjet e tij të lira. Kështu ka vepruar edhe me përmbledhjen të botuar në dy gjuhë, gjermanisht dhe shqip "Gedichte fur Frauen und Balsaminen", "Poezi për gratë dhe lulet mosmëprek". Autorit Beat Brehbyl, i uroj jetë të gjatë dhe të na sjell edhe vepra tjera të veçanta dhe interesante.

SEFERI VAZHDON TË SHËNOJ

Taulant Seferi po kalon një periudhë të shkëlqyer. Pas golave në Kombëtaren Shpresa ai ishte vendimtar në ligën e dytë në Zvicër me Winterthur. Skuadra që synon ngjitje një kategori më lart mundi Vaduz me rezultatin 2-1. Goli i sulmuesit shqiptar në minutën e 34' rezultoi përcaktues për ndeshjen. Ky ishte goli i katërt në këtë sezon të Challenge League për Taulant Seferin, i cili luan i huazuar nga Young Boys. Winterthur në 11 javë kampionat ka grumbulluar 20 pikë. Liga e dytë në Zvicër ka shumë rivalitet, pasi pjesa më e madhe e ekipeve janë pranë me pikë. Në Superligë ngjitet direkt kampioni, ndërsa vendi i dytë luan takimet Play Off.



RASIM RAMADANI GJEN PAQE DHE KOMPENSIM NË PALESTËR

SPORTIN E KAM SI PROFESION

Për Rasim Ramadanin, sporti është vrasësi i përsosur i stresit. Shqiptari nga Maqedonia dëshironin ta kalon kohën me konsumatorë në palestrën e tij të boksit



Koha Fisnik NUHIU

Rasim Ramadanin jetonte në Shkup, pikërisht në Duqangjik pas teatrit në Bitpazar. Në fundjavë dhe në verë, familja e tij udhëton për të kaluar kohën në shtëpinë e tyre në fshat. E gjithë për shkak se në qytet, nxehësia është e padurueshme. Vendi në fshat karakterizohet nga malet dhe liqenet. Ushqim dhe pije: 44-vjeçarit i pëlqen të marrë verë nga Maqedonia, e cila lulëzon në klimën e thatë. Por edhe vorbull i mbushur me djathë dhe spinaq nuk duhet të mungojë.

Shkup, 21 tetor - Pikërisht 20 vjet pasi Rasim Ramadanin kishte udhëtuar nga Maqedonia në Austri, ai bëri një hap të madh drejt realizimit të ëndrrës së tij personale. Në maj të vitit 2016, ai hapi palestrën e tij të boksit në qytetin e tij ku jeton në Austri. Palestra e tij është e vendosur në një ndërtesë të re, ku dhe 44-vjeçari banon aty afër. Që kur ishte 14 vjeç, ai merrej me sport dhe sidomos me boks - një rol të rëndësishëm në jetën e tij. Ramadanin flet shumë për forcën mendore, paqen e brendshme, shëndetin dhe luftën kundër stresit. Ai dëshiron të kalojë të gjithë këtë për klientët e tij. Ai shpreson se ndonjëherë mund të jetojë vetëm nga ky aktivitet. Për momentin, ditët dhe netët e tij janë shumë të zënë. Paralel me studion punon ai edhe si teknik i përpunimit nga ora 22 deri në 6 të mëngjes. Ramadanin vendosi të merrej me këtë trajnim pasi matura e tij nuk u njoh në Austri. Ai e do punën e tij si një trajner palestere dhe trajner personal. Në studion e tij, ai është fillimisht në një fazë të vogël, ndërsa më pas

shkon dhe merret me pjesëmarrësit. "Unë në Austri erdha për të studiuar inxhinieri mekanike. Por kjo nuk ishte e mundur pasi matura ime nuk u pranua, dhe pasi nuk pata mundësinë që të studioj, vendosa që të merrem me sport e boksit që e kisha dëshirë nga fëmijëria. Këtu në Austri hapa qendrën time të boksit, ku njëkohësisht punoj edhe si teknik. Jam i kënaqur shumë me punën që bëj, ku dhe ka raste që kam filluar të punoj apo të stërvitem nga ora 22 në mëbrëmje e deri në 6 të mëngjesit", thotë Rasim Ramadanin. Në vitin e fundit në gjimnazit Ramadanin mësoi gjermanishten në vend të gjuhës angleze. Ai dinte të fliste Rusisht dhe Frëngjisht. Herët ishte pyetja nëse duhet të shkonte në Austri, Gjermani apo Zvicër për të studiuar. Xhaxhai apo daja i tij jetonte me vite në Ternitz të Austrisë, prandaj Rasimi vendosi që të vendoset në Austri. "Gjuha nuk me bën problem pasi mësova që në

shkollë të mesme. Në fillim nuk isha i vendosur që të jetoj në Maqedoni apo të largohem, më pas vendosa të shpërngulem dhe erdha në Austri, pasi këtu kisha xhaxhain tim i cili jeton prej viteve. Me kalimin e kohës këtu bëra atë që e dëshiroja nga fëmijëria" shtoi Ramadanin. Në fëmijërinë e tij Ramadanin ka luajtur edhe në teatër Shkup, pasi edhe babai i tij ishte drejtor i financave në teatrin e kryeqytetit. Në moshën nëntëvjeçare, ai luajti ujkun e keq një nder shumë role tjera. E gjitha kjo ndryshoi në moshën 14 vjeçare, ai ndryshoi kostumet e teatrit për dorezat e boksit. Ai u trajnuua me pasion, por nuk mori pjesë në ndonjë ndeshje profesionale. "Dëshira ime gjithmonë ka qenë që një ditë të behem profesionistë dhe të ngjitem në skenë për të zhvilluar një ndeshje boks, mirëpo prindërit e mi nuk e kishin dëshirë që unë të ngjitem në skenë për të boksuar. Kështu që në atë kohë



vendosa të ndëgjojë prindërit të cilët për mua janë shumë të respektuar", theksoi Rasim Ramadanin. Ai më vonë ishte në gjendje të ndjekë pasionin e tij për sportin edhe në ushtri atë kohë, mirëpo kur trazirat filluan në Maqedoni, ai vendosi që të braktissh vendin për të larguar drejt Austrisë. "Trazirat kur filluan në Maqedoni vendosa të largohem, këtë e bëra pasi nuk dua që të luftoj kundër civilëve", tha Ramadanin. Vendi ku banon në Austri është bërë shtëpia e tij e dytë. Aty ka krijuar miqësinë e tij të re, ka ndërtuar dhe aty punon ku

dhe arrin që të gjen paqen. Dy prej vëllezërve të tij jetojnë në Austri ndërsa tjetri në Zvicër. Ai viziton Maqedoninë dy deri ose tre herë në vit. Më herët ka udhëtuar nga Austri për në Maqedoni shumë me makinë, ndërsa sot shpesh fluturon me aeroplan nga Bratislava: "Kohë më parë kam udhëtuar në Maqedoni me makinë, por tani makinën kam lënë anash dhe shpesh udhëtoj me aeroplanë. Këtë e bëj për të vizituar vendin ku un jam rritur si dhe dy motrat e mia që jetojnë aty", deklaroi Rasim Ramadanin.

Demiri me Mariupolin mundin Zoryan

Shkup, 21 tetor - Futbollisti shkupjan Besir emiri me ekipin e tij Mariupol kanë arritur që të shënojnë fitore ndaj Zorya me rezultat 3:2 dhe ta kalojnë në tabelën e klasifikimit. Mbrojtësi i majtë i kombëtares shqiptare ishte në fushë nga minuta e parë për Mariupolin, që me Borjaçuk arriti të realizonte dy herë në pjesën e parë të takimit në të 30 dhe 36. Mysafirët në fillim të pjesës së

dytë të takimit patën rastin të zvogëlojnë rezultatin në 2:1 nga pika e bardhë, mirëpo Koçergin nuk arriti të realizon nga 11 metërshi. Ndërkohë që skuadra e Demirit gjeti edhe golin e tretë me anë të Zubkov në minutën e 83. Miqtë e Zoryas arritën që të shënojnë dy gola në fund të përballjes por ishte gjitha shumë vonë. Gromov në minutën e 90 shënoi për Zorian golin e parë,

kurse tre minuta më pas realizoi Koçergin duke zvogëluar epërsinë në 3:2. Gjithsesi kjo nuk mjaftoi për mysafirët dhe rezultati përfundimtar përfundoi 3:2 për ekipin e Mariupol të Besir Demirit. Ekipi i Mariupolit më këtë fitore tani radhitet në vendin e pestë në tabelë me 17 pikë të tubuara. Javën ardhme Mariupol do të jetë mysafirë e skuadrës së Detsna. (F.N)



NBA

HOUSTON MPOSHT LAKERS, GRUSHTE NË FUSHË MES RONDO DHE PAUL

NBA dukej se i kishte munguar çdo tifozi anembanë botës, për spektaklin dhe adrenalinën që përcjell. Një ndeshje fantastike ajo mes Houston Rockets dhe Los Angeles Lakers në "Staples Center", e cila u mbyll me fitoren e Rockets 124-115



NBA - REZULTATET

Indiana - Brooklyn	32-112
Washington - Toronto	113-117
New York - Boston	101-103
Philadelphia - Orlando	116-115
Chicago - Detroit	116-118
Miami - Charlotte	112-113
Dallas - Minnesota	140-136
Denver - Phoenix	119-91
Portland - San Antonio	121-108
Lakers - Houston	115-124

Tjetër humbje për Lakers në kampionat, këtë herë në fushën e saj, ku në dy ndeshje të luajtura deri më tani ende nuk ka regjistruar asnjë fitore. Houston triumfoi 124-114 në Los Anxhelos, duke korrur fitoren e parë sezonale, ndeshje e shkëlqyer e James Harden, autor i 36 pikëve, mbështetur edhe nga Chris Paul me 28 pikë e 10 asist. Për Lakers u dallua

LeBron James me 24 pikë, me 7 lojtarë të ekipit vendës që realizuan mbi 10 pikë, por që s'mjaftuan për të evituar humbjen. Por kjo ndeshje pati një fund të shëmtuar, kur në shifrat 108-109 për miqtë, me 5 minuta nga fundi, plas një sherr masiv në fushë, ku protagonistë janë Rajan Rondo për Lakers e Chris Paul për Houston. Pas debateve është Rondo ai që godet me grusht

në fytyrë Paul, që reagon dhe në këtë sherr përfshihet edhe Ingram. Të tri këta lojtarë e mbyllin para kohe ndeshjen, por në fushë hyjnë stafet e dy ekepeve për të qetësuar gjakrat. Fitoren e dytë sezonale korri Portland, që mundi 121-108 San Antonio, duke e nisur mjaft mirë kampionatin (Lillard 29 pikë e McCollum 24). Tri fitore në tri ndeshje të luajtura për Toronton,

skuadra më e mirë për momentin në NBA, me kanadezët që triumfuan 117-113 në fushën e Washington (Lowry 28 pikë e 12 asist). Fiton edhe skuadra e Boston, që mundi 103-101 New York në sekondat e fundit falë 24 pikëve e 14 rebaunder të Tatum, ndërsa Detroit fitoi 118-116 ndaj Chicago, ndeshje ku u dallua Griffin me 33 pikë e 12 rebaunder.



Serena Williams konfirmon Australian Open

Tenistja amerikane Serena Williams do të rikthehet në janar në grand slam të Australian Open, ku këtë vit nuk luajti për shkak se kishte vetëm 5 muaj që ishte bërë nënë. Hera e fundit që "pantera e zezë" ka luajtur në fushat me çement të Melbourne është finalja e vitit 2017, ku ajo triumfoi dhe mori titullin (mundi në finale motrën e saj Venus), të cilin nuk e ka mbrojtur. "Në një farë mënyrë e konsideroj veten ende kampione aty, pasi vjet nuk luajta dot për shkak se kisha vetëm pak muaj që kisha lindur vajzën Olympia. Ndaj mezi pres të jem sërish aty, të luaj sërish në Melbourne, një turne që më pëlqen shumë", u shpreh Serena Williams, që në Australian Open ka fituar 7 herë në karrierën e saj. Rikthimin e tenistes amerikane e kanë konfirmuar edhe organizatorët, që shprehen të lumtur që një kampione si Serena Williams do të jetë aty, një teniste që ka shumë fansa dhe sjell shumë sponsorë. Këtë vit, Serena arriti të shkojë deri në finale e dy grand slem, Wimbledon dhe US Open, por në të dyja rastet e u mund, ndaj ajo synon të rikthehet fituese në Australian Open.

Babai i Khabib fton McGregor në Dagestan: Është i mirëpritur në shtëpinë time

Pavarësisht fjalëve të rënda që Conor McGregor ka thënë karshi babait të Khabib Nurmagomedov, ai shprehet se nuk ka asnjë inat me sportistin irlandez. Abdulmanap Nurmagomedov, babai i kampionit të botës në peshën e lehtë në artet marcialle mikse, i ka shtrirë dorën irlandezit, duke thënë se e ka falur. Jo vetëm kaq, por ai e ka ftuar të vijë në shtëpinë e tij në Dagestan, për ta takuar dhe... për t'u stërvitur së bashku. "Të dashur miq. Unë e kam bërë edhe më parë një ftesë, që e përsëris edhe sot. Unë ftoj të vijë në Dagestan Oleg



Taktarov dhe Conor McGregor, që të marrin pjesë në turneun që do të organizojmë. E kam thënë edhe

më parë, që e kam falur Conor për të gjitha fyerjet dhe fjalët që ka thënë kundër meje. E rëndësish-

me është që njerëzit të jenë dashamirës me njëri-tjetrin", u shpreh Abdulmanap Nurmagomedov. Khabib mundi me "KO" në raundin e katërt McGregor, në eventin UFC-229 që u zhvillua më 6 tetor në Las Vegas, ku mes dy sportistëve e stafëve përkatëse nisi edhe një sherr masiv pas duelit. Pas atij incidenti, babai i Khabib e ka kritikuar djalin për sjelljen që ka bërë, ndërkohë që sot ka ftuar në Dagestan, vendlindjen e tyre, Conor McGregor, ish-kampionin e botës, duke thënë se është gati ta ndihmojë në stërvitje.

Marquez shpallet për të 7-n herë kampion bote

Marc Marquez është shpallur sot kampion bote në Moto GP për sezonin 2018-2019, titulli i shtatë kampion në karrierën e pilotit spanjoll të Honda, i pesti në kategorinë më të lartë të motoçiklizmit (ka edhe një titull në Moto 2 e një në Moto 3). Spanjollli bëri një garë fantastike në pistën e Motegi, duke fituar garën e Çmimit të Madh të Japonisë, të cilën e nisi nga vendi i gjashtë dhe e mbylli si triumfues. Ai përfitoi edhe nga

dalja jashtë piste xhiron e parafundit të rivalit të tij kryesor Andrea Dovizioso, për të festuar matematikisht titullin, plotësisht i merituar. Edhe pse e nisi garën nga vendi i gjashtë, spanjollit të Honda-s i mjafton një xhiro për t'u ngjitur në vendin e dytë dhe për të nisur një duel me Dovizioso (Ducati), ashtu siç ka ndodhur pothuajse përgjatë gjithë këtij sezoni. Dy pilotët dhurojnë spektakël në pistë, por italiani nuk duron dot presionin dhe

del nga pista xhiron e parafundit, duke nisur kështu festën e spanjollit, që shpallet kampion edhe pse ka ende 3 gara nga fundi. Për Marquez ky është suksesi i tetë sezonial, ndaj dhe triumfi është tërësisht i merituar dhe torta që Honda kishte përgatitur për të festuar që në Motegi, në pistën e saj, nuk shkoi dëm. Në vendin e dytë sot u rendit britaniku Cal Crutchlow dhe pas tij Alex Rins. Vetëm i katërti Valentino Rossi me Yamaha, 6



sekonda pas fituesit, një garë në dritë-hije për italianin, që e nisi atë nga vendi i nëntë. Por festa është e gjitha për Marc Marquez,

që mbylli të gjitha llogaritë dhe tani feston një tjetër triumf. Rekordet e Rosit janë vënë në shënjestër.

CONTE NIS NEGOCIATAT, "DRIDHEN" TRAJNERËT E DY KLUBEVE TË MËDHA

Antonio Conte është favorit i nxehtë për të marrë përsipër detyrën e trajnerit të Real Madridi nëse shkarkohet Julen Lopetegui, me raportet që thonë se italiani ai u kontaktua më 2 tetor ndaj drejtuesit të Mbretërve



Lajmi, që nuk zbulon shumë, është nga ato që mund të ndikojë në ekuilibrin e stolave të klubeve kryesore të futbollit evropian. Siç ka bërë të ditur "Il Giornale", Antonio Conte ka nisur negociatat për të prishur kontratën që e lidh me Chelsea deri në 30 qershor të 2019-ës. Këto negociata nuk pritet të jenë të lehta, duke parë mënyrën sesi është larguar trajnerin italian nga "Stamford Bridge". Numri një i londinezëve, Abramovich, ka provuar të përdorë edhe

kartën e shkarkimit të justifikuar nga detyra, që do ta kishte ndihmuar atë të kursente 9 milionë euro. Një shkarkim i justifikuar që bazohet te sms-të e famshme që Conte i dërgoi Diego Costa-s në verën e 2017-ës, duke shtyrë sulmuesin të largohej tek Atletico Madrid. Me pak fjalë, nuk duhet të jetë një atmosferë e mirë gjatë negociatave, që kanë filluar të shunën me një takim mes drejtuesve të Chelsea dhe avokatëve të Contes, i cili do të pretendojë një

dëmshpërblim të barabartë me 4 milionë euro. Gjithsesi, ky lajm do të jetë shqetësues për të paktën dy trajnerë. I pari është ai i Real Madrid, Julen Lopetegui, fati i të cilit është i varur në fije të perit, që mund të këputet në rast të një humbjeje kundër Barcelonës të dielën e ardhshme. Por nuk është i qetë as trajneri i Romas, Eusebio Di Francesco, skuadra e të cilit ka pësuar një humbje befasuese 2-0 në kampionat kundër Spal. Nuk duhet harruar edhe se Conte është

përfolur për një transferim të Milan që nga momenti që klubi milanez ka kaluar në duart e Fondit Eliott. Por "AS" ka zbuluar se presidenti Florentino Perez ka biseduar me italianin Antonio Conte dhe e ka prenotuar kohë më parë, që kur Reali u mund 1-0 në Moskë nga skuadra e CSKA-së, tri javë më parë në Champions. Ish-trajneri i Juventusit, Chelsea dhe kombëtares "azzurre" është i lirë dhe gati për të nisur një aventurë të re, duke marrë drejtimin e Real.



Rooney u largua nga Anglia shumë herët

Trajneri i Crystal Palace, Roy Hodgson, ka thënë se ish-sulmuesi i Manchester Unitedit, Wayne Rooney, u largua shumë herë nga futbollit anglez dhe se ai mund të ishte ende duke shkëlqyer në Premierligë, nëse nuk do të ishte larguar. Ish-sulmuesi i Manchester Unitedit dhe Evertonit u largua nga Premierliga gjatë afatit kalimtar të verës si transferim i lirë. Ai iu bashkua skuadrës së DC Unitedit në ligën amerikane të futbollit, Major League Soccer. Hodgson, i cili ishte trajner i Kombëtares së Anglisë kur Anglia u bë golashënuesi më i mirë i Anglisë, ka insistuar se Rooney vazhdon të mbetet mjaftueshëm i mirë për të shkëlqyer në Premierligë, por e ka kuptuar se ai nuk dëshiron të luante për ndonjë klub tjetër në vendin e tij. "Ai u largua nga Anglia shumë herët. Ai ende ka shumë gjëra për të dhënë. Nuk kam asnjë dyshim për talentin e tij dhe tashmë e ka dëshmuar se ai mund të luajë ende në nivelin më të lartë të futbollit në Angli", ka thënë Hodgson. "Por, ishte vendimi i tij dhe pas Manchester Unitedit dhe Evertonit, ku ai kishte afinitet të mrekullueshëm, rrënjë të thella, ndoshta ai nuk ishte i interesuar të luante për ndonjë klub anglez përpos këtyre dyve. Ishte një vendim i vetëdijshëm për të luajtur jashtë Anglisë. Kam respekt të madh për Rooney dhe mendoj se edhe ai ka respekt për mua", theksoi Roy Hodgson.

Real ofron 100 milionë stërlina për Sterling

Real Madrid është gati të bëjë një blerje "big" në janar, duke parë situatën aspak të mirë që ka pushtuar skuadrën "merengues" dhe në krye të listës është mesfushori i Manchester City, Raheem Sterling. Ai nuk u aktivizua asnjë minutë dje, në fitoren 5-0 që City arriti ndaj Burney, ndërkohë që prej muajsh talenti britanik nuk ka rinovuar kontratën me kampionët e Anglisë. Këtë javë, ai realizoi 2 gola për kombëtaren e Anglisë në përballjen ndaj Spanjës në Ligën e Kombeve, duke shtuar edhe më shumë interesin e ekipit madrilen. Për këtë arsye, gjigandët spanjollë janë gati t'i ofrojnë një rrogë të mirë Sterling, deri në 175 mijë stërlina në javë, ndërkohë që aktualisht ai përfiton 100 mijë stërlina në javë te

City. Kontrata e Sterling me City skadon pas 18 muajsh, në verën e vitit 2020 dhe palët nuk po gjejnë një marrëveshje për ta rinovuar atë. Ndaj Real Madrid kërkon të përfitojë nga kjo situatë, me presidentin Florentino Perez që është gati të paguajë 100 milionë stërlina për ta sjellë talentin 23-vjeçar në "Santiago Bernabeu". Sipas mediave britanike, ky transferim ka gjasa të realizohet që në janar të këtij viti, pasi madrilenët janë në kërkim të një lojtari të shpejtë, që luan si në krah ashtu dhe para porte për të dalë nga kriza. Ky transferim do të ishte një grusht i rëndë për trajnerin Pep Guardiola, që e vlerëson shumë lojtarin dhe prej muajsh i kërkon klubit që t'i rinovojë kontratën Sterling.



Dëmtimi i Messit, ja kur pritet të rikthehet

Lionel Messi u dëmtua në bërryl gjatë një dyluftimi me futbollistin e Sevillas, Mudo Vasquez, në sfidën e mbrëmshme në "Camp Nou" dhe u detyrua të lërë fushën e lojës në minutën e 26', ndërkohë që deri atëherë kishte shënuar një gol dhe kishte asistuar një tjetër. Kontrolllet e para mjekësore për yllin argjentinas, kanë konfirmuar frikën e madhe, pasi Kapiteni i Barcelonës duket se ka humbur

tashmë sfidat me Interin në Ligën e Kampionëve, por edhe El Clasicon me Realin e Madridit, planifikuar për në fundjavë. "Pleshti" pritet të rikthehet në fushë në mesin e nëntorit, përpara sfidës së rëndësishme kundër Atletico Madrid në "Wanda Metropolitano". Takimet e tjera ku numri 10 i Barças do të mungojë janë ato përballë Vallecansos, përsëri kundër Interit në Champions Lea-

gue, Leonesas për kupë, dhe Betisit të Sevillas. Natyrisht që ky është një lajm dëshpërues për trajnerin Valverde, që do të duhet të bëjë pa lojtarin më të mirë të ekipit, në një fazë mjaft të rëndësishme të sezonit, ku do të përballlet me kundërshtarë të një niveli të lartë. Dembele e tregoi edhe dje, se nuk mund t'i besohet shumë, ndërsa Malcom është jashtë planeve të teknikut Valverde,



që tashmë do të duhet të mendojë se kujt do t'ia besojë zëvendësi-

min e Lionel Messit në fushën e lojës.

SHIFRA REKORD NGA ARABIA, 4 MILIARDË STËRLINA PËR TË BLERË UNITED

Manchester United shumë shpejt mund të kalojë në pronësi të princit të Arabisë Saudite, Mohammad bin Salman, djali i mbretit Salman. Mësohet se princi 33-vjeçar, pasardhësi i fronit, ka bërë një ofertë marramendëse prej 4 miliardë stërlinash për të marrë skuadrën e Unitedit



Manchester United mund të ndryshojë së shpejti pronësi. Sipas të përditshmes "Mirror", skuadra e "djajve të kuq" shumë shpejt mund të kalojë në pronësi të princit të Arabisë Saudite, Mohammad bin Salman, djali i mbretit Salman. Mësohet se princi 33-vjeçar, pasardhësi i fronit, ka bërë një ofertë marramendëse prej 4 miliardë stërlinash për të marrë skuadrën e Manchester United. Kjo ofertë ka mbërritur në tavolinën e njërit prej bashkëpronarëve të United, Avram Glazer, që këto ditë ka qenë në Riyadh të Arabisë Saudite, për një forum ndërkombëtar. Pikërisht gjatë këtij forumi Gla-

zer ka takuar Princin e Arabisë, që i ka shprehur personalisht interesin e tij për të blerë skuadrën legjendare të Premier League. Por pronari aktual i United nuk ka dhënë asnjë përgjigje të menjëhershme dhe ka kërkuar kohë. Mohammad bin Salman është përfshirë në një skandal kohët e fundit në vendlindjen e tij, pasi ai akuzohet si baskhë-

punëtor në vrasjen e gazetari të pavarur, në atë që është quajtur si "çështja Kashoggi", ende e pazgjidhur. Nëse kjo gjë konfirmohet, ai mund të humbasë fronin. Ndaj dhe Avram Glazer nuk dëshiron të hedhë hapa të pamenduara mirë dhe pret që Princi të zgjidhë këtë çështje para se të ulet në bisedime. Avram Glazer e ka blerë skuadrën e Man-

chester United në vitin 2005, duke paguar shumën e 790 milionë stërlinave, ndërkohë që tani do të arkëtonte 4 herë më shumë. Forbes e ka vlerësuar skuadrën e Manchester United 3.2 miliardë stërlina, por duke parë humbjet që ky klub ka patur vitet e fundit, fitimi neto që Glazer do të kishte nga kjo shitje është 2,2 miliardë stërlina.



Chelsea do ta bëjë Hazard lojtarin më të paguar në Premier League

Chelsea do ta bëjë sulmuesin belg Eden Hazard lojtarin më të paguar të historisë së Premier League, pasi "blutë" e Londrës kanë gati ofertën e pazezistueshme për 26-vjeçarin. Si dhuratë për Krishtlindje, skuadra londineze do t'i ofrojë talentit belg një kontratë prej 350 mijë stërlinash në javë, si askush tjetër në Premier, duke shpresuar që me këtë shifër ai të qëndrojë përgjithnjë me Chelsea. Lajmin e ka konfirmuar sot e përditshmja britanike "The Express", sipas së cilës palët kanë rënë dakord parimisht, por gjithçka do të zyrtarizohet vetëm në fund të këtij viti. Aktualisht, Hazard përfiton 200 mijë stërlina në javë dhe kontrata e tij me Chelsea skadon në verën e 2020-ës, pra pas 18 muajsh. Por me kontratën e re, sulmuesi do të përfitojë 350 mijë stërlina, një shumë që është gati dy herë më e lartë se ajo aktuale, shumë të cilën nuk e ka asnjë futbollist tjetër në Angli. Chelsea, fillimisht synonte ta paguante lojtarin 300 mijë stërlina në javë, por duke parë presionin që erdhi nga Real Madrid dhe paraqitjet e mira që Hazard ka bërë muajt e fundit është detyruar të rrisë ofertën. Aktualisht, lojtari më i paguar në Premier League është Alexis Sanchez, që merr 315 mijë stërlina në javë, ndjekur nga Ozil me 306 mijë dhe Pogba me 290 mijë stërlina në javë. Por me rrogën e re, Hazard do t'i vërë në resht të gjithë rivalët e tij.

Napoli ofron 35 milionë euro për Piatek, por nuk bind dot Genoan



Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis provoi të mposhtë konkurrencën me ekipet e tjera për të takon Krzysztof Piatek, por pa që tentativa e tij nuk shkoi siç e kishte planifikuar. Numri një i të kaltërve ofroi plot 35 milionë Euro për blerjen e menjëhershme të 23-vjeçarit polak dhe lënien e tij në huazim te

ekipi i drejtuar nga Ivan Juric deri në fund të sezonit, por presidenti i Genoas refuzoi menjëherë. 70-vjeçari Preciosi nuk ka aspak ndërmend të privohet nga lojtari në këto momente, pasi shpreson që gjatë merkatos të përfshihen edhe ekipe të tjera dhe të hapet një ankand.

Bolt ia del mbanë, australianët e Mariners i ofrojnë kontratë 2-vjeçare

Pak ditë më parë, Usain Bolt refuzoi një kontratë 2-vjeçare nga Malta, nga skuadra e La Valletta. Por ish-sprinterit xhamajkan ka marrë sot lajmin e mirë se ekipi australian i Central Coast Mariners, me të cilin po stërvitet prej më shumë se një muaji, i ka ofruar një kontratë 2-vjeçare. Lajmin e ka konfirmuar e përditshmja "The Australian", sipas së cilës xhamajkani e ka kaluar provën dhe mund të luajë si futbollist profesionist. Usain Bolt është rekordmen bote në 100 dhe 200 metra në atletikë, sport të cilin e ka brak-



tisur një vit më parë, kur vendosi t'i dedikohet tërësisht futbollit. Që prej shtatorit, xhamajkani po stërvitet me ekipin e A-League në Au-

stralia, Central Coast Mariners, madje duke u aktivizuar edhe në dy miqësore. Në takimin e dytë ai realizoi edhe dy gola, çka ka bindur stafin drejtues të këtij ekipi t'i ofrojë një kontratë 2-vjeçare. Duket se 32-vjeçari nga Xhamajka ia doli mbanë të bëjë realitet ëndrrën e tij dhe të luajë futboll me një ekip profesionist, çka mund t'i hapë dyert në të ardhmen për të luajtur në nivele edhe më të larta, pavarësisht moshës. Ëndrra e Usain Bolt është që të luajë me Manchester United, skuadrën e tij të zemrës.




Di Francesco në presion, katër ndeshjet e ardhshme vendimtare

Trajneri i Romës, Eusebio Di Francesco, raportohet se është afër shkarkimit, pas humbjes së vendosur me 2 nga Spali të shtunën. Edhe pse e mbylli sezonin e shkuar në pozitën e tretë dhe arriti gjysmëfinalen e Ligës së Kampioneve, ai është në presion të lartë në Stadio Olimpico. Pas një krize në fillim të sezonit, Di Francesco shënoi katër fitore rresht, por që u ndal nga Spali. Sipas "Corriere dello Sport", presidenti i klubit James Pallota është i gatshëm ta shkarkojë Di Francescon, por ka vendosur t'i japë edhe një muaj kohë. Katër ndeshjet e ardhshme do të jenë vendimtare për Di Francescon. Ai do të përballlet dy herë në Ligën e Kampioneve me CSKA-në e Moskës dhe me Napolin e Fiorentinën në Itali. Pas nëntë ndeshjeve deri tash, Roma ka vetëm 14 pikë dhe është në pozitën e gjashtë, me 11 pikë më pak se lideri Juventus.

"I kemi 3 njerëz që kanë bërë plagjiaturë, e kemi Nexhat Dacin që ka bërë plagjiaturë prej Musa Limanit, e kemi Sabri Hamitin që ka bërë plagjiaturë edhe e kemi Arsim Morinën që është po ashtu prej fushës së mjekësisë. Janë tre pjesëtarë të Akademisë për të cilët kanë dalë fakte të forta në medie ndër vite, kryesisht pas luftës për plagjiaturën e tyre dhe Akademia nuk ka ndërmarrë kurrfarë mase", ka thënë Shkëlzen Gashi nga organizata "Integra"

HULUMTIMI "KRIZA NË AKADEMI"

PLAGJIATURA E AKADEMIKËVE, SI PËRGGJIGJET NEXHAT DACI?



Akuzave për plagjiaturë dhe rrikave për mospunën e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), u është përgjigjur kryeakademiku Nexhat Daci, ka thënë se nuk merret me polemikat e organizatave joqeveritare, për të cilat tha se janë të pabaza.

Në mbledhjen e 8 tetorit 2018 të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Kulturë, anëtarë të organizatës "Integra", e cila së fundmi ka monitoruar punën e ASHAK-ut, kanë akuzuar këtë institucion për "gërryerje" të parasë publike. Këto akuza i janë drejtuar ASHAK-ut, për shkak të të gjeturave të hulumtimit "Kriza në akademi", autor i të cilit është Shkëlzen Gashi nga organizata "Integra".

Të gjeturat e këtij hulumtimi, anëtarë të kësaj organizate i kanë cilësuar si brengosëse dhe neveritëse, sepse, sipas të dhënave, nga 4 projekte të mëdha të këtij institucioni, vetëm një ka përfunduar, tre anëtarë të saj janë të akuzuar për plagjiaturë, shumica e librave janë ribotime, etj.

Lidhur me akuzat për cilësinë e botimeve dhe të projekteve të Akademisë, kryeakademiku Daci i tha Ekonomia Online se ky institucion ka botimet më të rëndësishme të projekteve dhe librave. Ai shtoi se Akademia do t'u ndihmojë gjith-

monë institucioneve shtetërore, siç tha, për të mirën e qytetarëve dhe të rinisë.

"Unë nuk polemizoj me OJQ-të, faktografinë që e kanë dhënë për botimin e veprave shkencore janë gënjeshtër, të pasakta. Shteti e ka bërë ndërtesën dhe Akademia gjatë gjithë viteve ka botimet më të rëndësishme të projekteve dhe librave. Çka bëjnë të tjerët është çështje e tyre. Unë kurrë nuk kyçem në polemika të cilat nuk i konsideroj, por Akademia do të jetë gjithmonë ndihmesë e institucioneve shtetërore për të mirën e qytetarëve të Kosovës dhe të rinisë, këto të tjerat.., burimet financiare e bëjnë që një organizatë lobon për diçka dhe tjetra për diçka, Akademia nuk e çan fare krytë për atë punë", tha Daci për E.O.

I pyetur lidhur me një nga të gjeturat e hulumtimit "Kriza në akademi", e cila thotë se nga 22 anëtarë të rregullt të ASHAK-ut, vetëm 3 kanë nga 3 punime të publikuara në revista akademike ndërkombëtare, ndërkaq prej 16 anëtarëve korrespondentë, 8 prej tyre kanë punime të publikuara në revista akademike ndërkombëtare, 3 nga 1 punim, 3 nga 3 punime dhe 2 të tjerë i kanë nga 6 përkatësisht 8 punime, Daci përsëriti qëndrimin e tij se nuk "kyçet në polemika të tilla pa bazë".

"Në librin që është, është mirë të gjitha organizatat me e pa se është CV e shkurtë dhe shumë e gjatë e kryetarit të Akademisë dhe atje e shihni se sa janë punime të botuara jashtë vendit, sa libra dhe për të gjithë, ka shumë veprimtari në Akademi, nuk ju intereson, por vetëm presin se çka mundën me sha, jo vetëm akademinë por të gjitha, prandaj unë nuk kyçem në polemika të tilla pa bazë", tha Daci.

Daci është përgjigjur edhe për deklaratat e anëtarëve të organizatës "Integra", të cilët në Komisionin për Arsim, të mbajtur më 8 tetor 2018, kanë thënë se Akademia e Shkencave ka qenë më aktive në kohën e Millosheviqit sesa tani.

"Unë nuk i kam dëgju, ata qenkan nostalgjikë atëherë të etapës së Millosheviqit. Akademia e ka shkruar deklaratën kushtetuese, deputetët e asaj periudhe e kanë lexuar atë që e ka shkruar Akademia, Kushtetuta e Kaçanikut po ashtu është prej akademisë, ndërsa kush ka nostalgji për Millosheviqin udha e mbarë i qoftë bashkë te Millosheviq", ka thënë Daci.

Shkëlzen Gashi, nga organizata "Integra", njëherësh autor i hulumtimit "Kriza në Akademi" ka thënë se Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës që nga viti 2007 buxhetit të Kosovës i ka marrë afro 10 milionë euro dhe nga 4

projekte që ka pasur vetëm dy prej tyre janë realizuar. Sipas Gashit, dy projektet e realizuara kanë shumë vërejtje dhe janë të punuara në mënyrë joprofesionale. Ai shtoi se prej 10 milionëve, 2/3 e buxhetit kanë shkuar për paga dhe mëditje të akademikëve. Gashi përmendi akademikët të cilët, sipas tij, kanë bërë plagjiaturë dhe se askush nuk ka ndërmarrë kurrfarë mase rreth kësaj çështjeje.

I kemi 3 njerëz që kanë bërë plagjiaturë, e kemi Nexhat Dacin që ka bërë plagjiaturë prej Musa Limanit, e kemi Sabri Hamitin që ka bërë plagjiaturë edhe e kemi Arsim Morinën që është po ashtu prej fushës së mjekësisë. Janë tre pjesëtarë të Akademisë për të cilët kanë dalë fakte të forta në medie ndër vite, kryesisht pas luftës për plagjiaturën e tyre dhe Akademia nuk ka ndërmarrë kurrfarë mase", shtoi Gashi.

Në hulumtimin "Kriza në Akademi", ndër të tjera shkruan: "Në vitin 2018, Kuvendi i ASHAK-ut për kryetar zgjodhi akademik Nexhat Dacin, i cili më 10 nëntor 2010 ishte dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me 18 muaj burg me kusht për shpërdorim të detyrës zyrtare. Ky vendim ishte konfirmuar edhe nga një trup gjykues i Gjykatës Supreme, me dy gjykatës vendore e një të EULEX-it".



Kosovë, paga mesatare u rrit me 30% në 5 vite

Një shtetas i Kosovës që punon në sektorin publik ka marrë 125 euro më shumë në vitin 2017, krahasuar kjo me 5 vite më parë. Sipas raporti pesë vjeçar të publikuar nga Agjencia e Statistikave paga mesatare bruto në sektorin publik u rrit me 30.7 për qind në 2017, krahasuar me vitin 2012.

"Derisa, paga neto nga 353 Euro sa ishte në vitin 2012, u rrit në 474 Euro, një rritje prej 121 Eurosh, ose 34.3 për qind", thuhet në raport. Një rritje të konsiderueshme kanë pësuar edhe pagat e atyre që punojnë në sektorin e ndërmarrjeve publike. Në këtë sektor është edhe niveli me i lartë i pagave në Kosovë.

"Paga mesatare bruto në sektorin e ndërmarrjeve publike në vitin 2012 ishte 518 Euro, derisa në vitin 2017 ishte 667 Euro, një rritje prej 149 Eurosh, ose 28.8 për qind. Derisa, paga neto nga 465 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 592 Euro, një rritje prej 127 Eurosh, ose 27.3 për qind."

Më të diskriminuarit janë ata që punojnë në sektorin privat. Pagat e tyre kanë pësuar një rritje simbolike prej 15 eurosh.

"Sektorit privat, në vitin 2012 kishte një pagë bruto mesatare prej 367 Eurosh, kurse në vitin 2017 kishte 384 Euro, një rritje prej 17 Eurosh, ose 4.6 për qind. Derisa, paga neto nga 333 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 348 euro, një rritje prej 15 Eurosh, ose 4.5 për qind".

Duke llogaritur në mesatare të pagës në sektorin publik, privat dhe ndërmarrjet publike "në vitin 2012 paga mesatare bruto në Kosovë ishin 431 Euro, derisa në vitin 2017 ishte 528 Euro, një rritje prej 97 Eurosh ose 22.5 për qind"./SCAN

Serbët po tentojnë ta ndalojnë formimin e Ushtrisë së Kosovës

Në Serbi transformimi i FSK-së në Ushtri po interpretohet në mënyra të ndryshme. Sipas disa analistëve të Beogradit, Ushtria e Kosovës përbën një kërcënim për serbët e veriut.

Eksperti i çështjeve të konflikteve ndërkombëtare, Dragan Simeunoviç thotë se procesi i transformimit të FSK-së në Ushtri është një proces i pamundur të ndalohej, ngase siç thotë ai, e njëjta i përshtatet edhe interesave të disa fuqive botërore, përfshirë edhe SHBA-të.

"Megjithatë, shqiptarët mund



ta përdorin atë, sidomos para hyrjes në NATO, për okupimin e veriut", thotë Simeunoviç.

Ndërkaq, Igor Simiq nga Lista Serbe thotë se veprime të tilla të Prishtinës janë të pamundura.

Sipas Simiq, komuniteti ndërkombëtar duhet ta ndalojë formimin e Ushtrisë së Kosovës.

"Ne në Prishtinë besojmë se të tilla veprime janë të pamundura, sepse të njëjtat do ta rezikojnë paqen. Kjo është pse komuniteti ndërkombëtar duhet të parandalojë formimin e Ushtrisë dhe të ndalojë akte të mundshme të dhunës", thotë Simiq për gazetën "Kurir".

Kujtojmë se me miratimin e tri projektligjeve për FSK-në në Kuvend, i është hapur rrugë transformimit të kësaj force në ushtri.

Brexit, që premtuan mbështetësit e tij para referendumit të qershorit 2016, nuk ngjason aspak me atë që po negociohet sot. Aktivistët thonë se do të kishin votuar kundër, nëse do ta kishin ditur koston e vërtetë.

MBI 600 MIJË BRITANIKË MARSHUAN KUNDËR BREXIT-it



Londra është kthyer të shtunë në qendrën e manifestit të britanikëve kundër "Brexit" me gati 670.000 prej tyre që i janë bashkuar marshimit të organizuar nga #PeoplesVoteforBrexit, mbështetur edhe nga figura të njohura të politikës, artit, sportit e kulturës në vend.

Demonstrata duket të jetë më e rëndësishmja anti-Brexit që nga koha e referendumit dhe vjen në një kohë kur Theresa May nuk përfillet nga liderët e BE-së në diskutimet e nivelit të lartë në Bruksel, me Britaninë që sheh më pranë vështirësinë e një dalje pa marrëveshje nga blloku.

Gjysmë milionë e qytetarëve britanikë në shesh është një tregues i frikshëm për të ardhmen e vendit pas Brexit me qytetarët që marshojnë për të kërkuar një referendum të dytë të quajtur 'Votimi i Popullit në Mars'.

Organizatorët e mitingut, "Vo-

timi i Popullit" në Mbretërinë e Bashkuar, postuan në Tëitter: "Mbi një gjysmë milioni po marshojnë në Parlament sot, duke kërkuar një marrëveshje #PeoplesVote për marrëveshjen e Brexit. Të gjithë duhet ta dinë këtë".

Marshimi historik nisi nga "Park Lane" në mesditë dhe përfundoi në një tubim në Sheshin e Parlamentit, ku kryebashkiaku i Londrës Sadiq Khan dhe kuzhinierja e famshme Delia Smith ishin mes atyre që folën para turmës.

Aktivistët nga e gjithë Britania

arritën në Londër të veshur me rroba mbretërore blu të mbushura me yje të artë, duke vënë tabela që lexonin "Brexit në kosh tanë" dhe "Unë dua të them fjalën time për Brexit".

Protestuesve ju bashkuan edhe fytyra të tjera të famshme, duke përfshirë edhe komedianin Eddie Izzard, i cili ishte veshur me një kostum të marinës që valëviste flamuj britanikë dhe të BE.

Sadik Khan iu drejtua turmave në Sheshin e Parlamentit duke thënë se ishte një moment historik. Duke sulmuar kryeministren

May dhe të gjithë Brexiters ai shtoi se askush nuk kishte votuar për "ta bërë jetën më të vështirë për fëmijët dhe nipërit tanë".

"Sot marshojmë në një moment historik për demokracinë tonë. Një moment kur mijëra njerëz nga çdo cep i vendit tonë dhe çdo pjesë e shoqërisë sonë dalin në rrugë për të dëgjuar zërin e tyre. Gënjeshtrat, ligësitë dhe mashtrimet e fushatës së referendumit tani janë ekspozuar, dhe është e qartë se vullneti i popullit po ndryshon. Askush nuk votoi për të lënë BE-në për ta bërë veten më të varfër. Askush nuk votoi për të parë dëmtimin e NHS-së tonë. Dhe askush nuk votoi për shqetësimet që ka krijuar kjo qeveri", tha Khan.

Diana Luck, nga Muswill Hill, është një nga shumë gra në marshim që mbanin shenja të 'gjyshes së zemëruar'. "Unë jam shumë e zemëruar me gjërat që po ndodhin si Brexit dhe Trump dhe shumë të shqetësuar për të ardhmen për fëmijët dhe nipërit e mbesat e mia", tha ajo. Ajo shtoi se po marshonte, sepse demokracia ishte duke u gërryer dhe gjërat ku ajo besonte, si NHS, po kërcënoheshin.

Ndërkohë kryeministrja May ka refuzuar një referendum si ai që kërkon një marshuesit, pasi sipas saj votuesit në Britani kanë votuar pro daljes nga Bashkimi Evropian në qershor të vitit 2016 dhe duhet të përmbushet vullneti i tyre.

Britania pritet të dalë nga BE-ja më 29 mars të vitit 2019. Plani është të bëhet nja hap tranzicioni për lehtësim të pasojave të marrëdhënies mes BE-së dhe Britanisë. Por, për shkak të mosarritjes së një marrëveshjeje në mes të dyja palëve, afati mund të shtyhet.

Sidoqoftë, mesazhi është serioz: Brexit, që premtuan mbështetësit e tij para referendumit të qershorit 2016, nuk ngjason aspak me atë që po negociohet sot. Aktivistët thonë se do të kishin votuar kundër, nëse do ta kishin ditur koston e vërtetë.

Kryeministrja britanike e ka bërë të qartë se nuk do të lejojë një votim të dytë. Sidoqoftë, alternativat me të cilat përballlet Britania, për momentin variojnë nga një divorc i pastër pa asnjë marrëveshje, e deri te një ndarje me pak ndryshime, përveç faktit që Londra do të humbasë zërin e saj në BE.

TRUMP: SHBA TËRHIQET NGA TRAKTATI ME RUSINË PËR ARMËT BËRTHAMORE



Rusia ka reaguar ndaj deklaratave të presidentit amerikan Donald Trump, për tërheqje nga traktati bërthamor. Trump ka akuzuar Rusinë se ka shkelur traktatin bërthamor, sipas të cilit nuk lejohet përdorimi dhe transportimi i armëve raketore

për shkelje të marrëveshjes.

Rusia kishte kundërshtuar akuzat e SHBA-së duke theksuar se disa elemente të sistemit të armëve kanë qenë në kundërshtim me marrëveshjen.

Deklaratat e Trump vijnë disa ditë pasi Putini tha se Rusia mund të përdorë armët bërthamore në përgjigje ndaj ndonjë sulmi bërthamor në vend.

Rusia ka reaguar ndaj deklaratave të presidentit amerikan Donald Trump, për tërheqje nga traktati bërthamor. Trump ka akuzuar Rusinë se ka shkelur traktatin bërthamor, sipas të cilit nuk lejohet përdorimi dhe transportimi i armëve raketore.

Zëvendësministri i Jashtëm rus, Sergei Ryabkov, e ka quajtur këtë hap të rrezikshëm.

"Ky hap i rrezikshëm, do të provokojë pasojë shumë serioze", tha ai.

Traktati është "i njohur për siguri ndërkombëtare dhe siguri në fushën e armëve bërthamore, për të mbajtur strategjinë e stabilitetit", tha Ryabkov për media.

Ai tha po ashtu shtoi se nëse SHBA-të vazhdojnë me këto sjellje, duke u tërhequr nga marrëveshjet ndërkombëtare, Rusia nuk do të ketë zgjidhje tjetër përveç të marrë masa dhe të përfshijë teknologjinë ushtarake.

"Por, ne nuk do të dëshironim të arrijmë

në këtë pikë", shtoi ai.

Traktati i vitit 1987 i ndalon Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, posedimin, prodhi-

min dhe transportin e armëve raketore. SHBA kishte akuzuar Rusinë nga viti 2014 për shkelje të marrëveshjes.

Publicitet

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7, nenit 132 paragrafi 5 i Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018), Këshilli i shkollës pranë SHF "Goce Dellçev" – Konçë publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të Drejtorit të SHF "Goce Dellçev" – Konçë

1. Kandidati për Drejtor të shkollës, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin duhet ti plotësojnë edhe kushtet në vijim:

- të ketë të kryer së paku arsim sipëror
- të plotësojë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore,
- të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore,
- të ketë të dhënë provim për drejtor,
- të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet

2. Me fletëparaqitjen dhe biografinë e shkurtër, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Diplomë për arsim sipëror të mbarua
- Certifikatë të shtetësisë të Republikës së Maqedonisë
- Certifikatë se nuk është shqiptuar padi apo aktgjykim për vepra penale
- Vërtetim për përvojë pune në punë edukativo-arsimore
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor
- Program për punë në shkollë për periudhë katër vjeçare
- Vërtetim për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.

3. Orari ditor i punës së drejtorit është 8 orë në ditë apo 40 orë në javë, të ndarë në pesë ditë pune prej të hënës deri të premten prej ora 08:00 deri në ora 16:00.

4. Pagesa themelore neto është 30.953,00 denarë.

5. Shpallja zgjatë 8 (tetë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

6. Zgjedhja do të realizohet në afat në pajtim me nenin 132 nga Ligji për arsim fillor.

7. Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme origjinal ose kopje të vërtetuar në noter të dorëzohen personalisht ose përmes postës deri tek Këshilli i shkollës pranë SHF "Goce Dellçev" – f. Konçë, me shenjë për shpalljen publike për Drejtor të shkollës.

8. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

9. Kontakt telefoni: 032-649-145

Këshilli i shkollës së SHF "Goce Dellçev" – Konçë

BOTIME TË REJA

“PERLA GJUHËSORE”, AJTENE QAMILI

Në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës, “Koço Racin” në Shkup, të premten u promovua libri “Perla gjuhësore” nga studiuesja dhe profesoresha universitare Ajten Hajdari–Qamili, si rezultat i punës dhe hulumtimit disaveçar, e cila rezultoi me prurje të reja në fushën e albanologjisë



shkencor serioz me prurje në albanologji, e cila është realizuar si rezultat i një pune të gjatë.

“Punimi i Ajtenes është i mirë pasi që nuk është bërë për 1 muaj 2, apo 3-4, por me vite të tëra, vazhdimisht duke prezantuar nëpër simpoziume të ndryshme. Të gjitha punimet që i ka mbledhur në këtë botim me të vërtetë janë perla. Mund të konstatoj se vepra në fjalë përmban hulumtime shkencore serioze me prurje në albanologji”, vlerësoi profesori Ymeri, i cili është në pension, por për nder të angazhimit të profesoreshës, kishte pranuar ftesën për të qenë pjesë e promovimit.

Përpara të pranishmëve, fjalim mbajti edhe recensenti i veprës, profesori universitar, Asllan Hamiti, i cili tha se ky libër dëshmon formimin e gjerë dhe të shëndoshë të autores, ndërkaq theksoi gjithashtu se i njëjti do të shërbejë si burim referimi për studiuesit e tani-

shëm dhe të ardhshëm.

“Vepra në fjalë përmban hulumtime shkencore serioze, me prurje të reja në fushën e albanologjisë. Duke lexuar shkrimet e saj, jo vetëm që njihemi me të vërtetat shkencore për shqipen, por ato do të shërbejnë edhe si burim referimi për studiuesit e tanishëm e për brezat që do të vijnë. Teksti përshkohet nga një stil shkencor, e një shqipe standarde të kulluar. Një punë e tillë, dëshmon formimin e gjerë e të shëndoshë teorik, praktik dhe metodologjik të autores”, tha profesori Hamiti, duke falënderuar profesoreshën Ajten për veprimtarinë e frytshme që e jep në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave, në studimet albanologjike si dhe në përparimin dhe qytetërimin e përgjithshëm të popullit shqiptar.

Fjalë miradije dhe falënderim për ndihmën që i jep kulturës shqiptare, i shprehu edhe drejtori i

Shtëpisë së Kulturës Koço Racin, i cili tha: “profesoreshën kam pasur nderin ta njoh që para 6 viteve dhe prej atëherë kemi bashkëpunuar dhe na ka ndihmuar shumë për të realizuar projektet kulturore shqiptare. Profesoresha është punëtorë e vyer dhe një vepër si kjo do të na shërbejë të gjithëve”.

Sfida dhe dashuri për “perlat” “Dashuria është reciproke, reflektohet, pra është e dyanshme. Nëse mbjell dashuri padyshim që do të korrësh dashuri dhe e di që në këtë sallë ndihem aq e rehatshme, aq e lumtur, sepse e di që të gjithë ju që jeni këtu vërtet më doni dhe vërtetë ju dua”, me këto fjalë, autorja i përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit që e zbkuruan dhe madhëruan promovimin e botimit të saj.

“Këtë libër së pari desha ta titulloj Dromca gjuhësore, për shkak të modestisë dhe për të aluduar kontributin e vogël, megjithatë mora kritika nga miqtë e mi të cilët më thanë mjaft e shkele veten, jepja meritën që e ka ky libër. Atëherë thashë përsëri do të qëndroj te modestia ime, do ta emërotoj perlë, sepse perlat janë gjëra shumë të vogla, por në anën tjetër janë gjëra shumë të vlefshme. Por jo vetëm kjo, puna është edhe te vështirësia, për të arritur deri te perlat, meqë e dimë se duhet të zhytemi thellë nëpër detëra dhe oqeanë dhe me shumë vështirësi për t'i nxjerrë ato. Këto vështirësi i



kam hasur unë gjatë gjithë këtyre viteve, jo vetëm gjatë hulumtimit, meqë një pjesë e madhe e punimeve kanë qenë nga terreni, pastaj punë krahasimi, analize dhe mbi të gjitha më është dashur ndonjëherë të bie ndesh me arritjet gjuhësore të deritanishme dhe për të thënë ndryshe nga ajo që është thënë deri më tani. Për të marrë këtë guxim të duhen fakte dhe unë jam përpjekur të nxjerr këto fakte. Gjatë jetës sonë kemi shumë vështirësi, sidomos për gjininë femërore, sepse për të qenë edhe prind, edhe familjar, edhe mësimdhënës, edhe shkencëtar, është vërtetë sfidë dhe vështirësi e madhe. Edhe unë për t'i nxjerrë këto perla dhe të gjitha arritjet e mia e për të qenë sot kjo që jam para jush, kam përjetuar dhe përballuar stuhira të ndryshme, por barkën time nuk e ka shembur asnjë stuhi”, tha përpara të pranishmëve profesoresha.

“Qershia mbi tortë” ishte surpriza e studentëve të profesoreshës, të cilët atë e emocionuan dhe këndshëm e befasuan me një dhuratë modeste, në shenjë falënderimi për gjithë përkushtimin dhe punën e saj të palodhshme për ta.



ITSHKSH organizon Seminarin Ndërkombëtar të Ballkanologjisë

Shkup, 21 tetor – Të hënën dhe të martën në Shkup do të mbahet edicioni i parë i Seminarit Ndërkombëtar të Ballkanologjisë, në kuadër të të cilit i zhvillon punimet konferenca shkencore: “Ballkanologjia sot dhe komunikime ndërballkanike”.

Fjala e hapjes do ta mbaj dr.Qemal MURATI, Drejtues i Seminarit Ndërkombëtar të Ballkanologjisë, kurse me fjalë përshëndetëse do të paraqiten: Skender ASANI, drejtor i ITSHKSH-Shkup, Asaf ADEMI, ministër i Kulturës i Republikës së Maqedonisë dhe Arbër ADEMI, ministër i Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Maqedonisë. Seminari do të trajtojë tema të rëndësishme që do të paraqiten në kuadër të sesionit të letërsisë, sesionit të gjuhësisë dhe sesionit të etnokulturologjisë dhe historisë.

Është paraparë edhe promovim i disa veprave për Skënderbeun, transmeton gazeta KOHA.

“Nëntor i Ftohtë” dhe “Gardhi” në Festivalin e Selanikut

Në edicionin e 59-të të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Selanikut që do të mbahet nga data 1 deri më 11 Nëntor Kosova përfaqësohet me 2 filma; “Nëntor i Ftohtë” i regjisorit Ismet Sijarina dhe “Gardhi” nga regjisorja Lendita Zeqiraj.

Që të dy filmat do të jenë pjesë e Seksionit “Balkan Survey” i kuruar nga Dimitris Kerkinos. “Balkan Survey” ka shfaqur shembujt më të mirë të prodhimeve filmike nga rajoni i Ballkanit.

Regjisorë të mirënjohur, dhe ata debu-



tant trajtojnë një sërë temash sfiduese në thelbin e edicionit të sivjetshëm të 15 fil-

mave të metrazhit të gjatë dhe të shkurtë. “Balkan Survey” paraqet gjithashtu programin “Before the Wave Breaks” me 8 filma ikonikë të regjisorëve paraardhës të kinemasë së re rumune.

Festivali i Selanikut është njëri ndër festivale të vjetër dhe të rëndësishëm në Ballkan ku pjesë e programit të edicioneve të kaluara kanë qenë edhe filmat tjerë nga Kosova, si “Tri Dritare dhe një Varje”, “Home Sweet Home” “Si qeni n'rrush” etj. /ATSH

Filharmonia gjermane e Rinit në Maqedoni

Nuk ndodh shpesh që një orkester gjermane të organizojë një turne koncertesh në Maqedoni. Filharmonia Gjermane e Rinit udhëton në tetor 2018 për herë të parë drejt Maqedonisë për të zhvilluar dhe ruajtur kontaktet e saja kulturore. Orkestra, e cila do t'i paraqitet publikut vendas me dy koncerte, një Shkup dhe një në Tetovë (e hënë, ora 19.30), në kuadër të festivali ndërkombëtar „Skena e Muzikës Serioze Shqiptare”.

Muzikantët marrin me vete në valixhet e tyre: Sinfoninë ro-



mantike Nr. 3 nga Johannes Brahms, muzikë blues nga George Gershwin me „Rhapsody in Blue” dhe muzikë nga kompozitori i njohur në Maqedoni, Fatos Lumani.

Ky turne orkestral i Filharmonisë Gjermane të Rinit është i mbështetur ndër të tjera nga Goethe Institut, Ambasada Gjermane në Shkup si dhe shoqata kulturore “Allegretto” në Tetovë.

Programi: Johannes Brahms – Sinfonia Nr. 3 ne fa maxhor, Op. 90, Fatos Lumani – Koncert – Rapsodi per violinë, piano dhe orkester harqesh, George Gershwin – Rhapsody in Blue

Në bazë të nenit 68 paragrafi 2 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 48 paragrafi 2 dhe 3 nga Ligji për përcjelljen e komunikimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/18), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbartur më datë 18 tetor 2018, solli

**VENDIM
PËR PUBLIKIM TË SHPALLJES PUBLIKE PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE ANËTARËVE TË KËSHILLIT PËR MBIKQYRJE QYTETARE**

I. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikon shpallje publike për emërim të kryetarit dhe gjashtë anëtarëve të Këshillit për mbikëqyrje qytetare (në tekstin e më tejshëm: Këshilli) nga të cilët tre janë ekspert dhe tre janë përfaqësues nga organizatat (shoqatat) joqeveritare, nga sfera e mbrojtjes së të drejtave dhe liritë, sigurinë dhe mbrojtjen themelore të njeriut

II. Kryetar dhe anëtarë i Këshillit mund të jetë person i cili i përmbushë kushtet në vijim:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK, gjegjësisht shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit
- të ketë përvojë pune prej së paku shtatë vite në fushën e jurisprudencës, telekomunikimeve dhe teknologjive informatike apo pesë vite përvojë pune tek organizatat joqeveritare nga fusha e mbrojtjes së të drejtave dhe liritë, sigurinë dhe mbrojtjen e njeriut

III. Kandidatët e interesuar fletëparaqitjet për pjesëmarrje në këtë shpallje, biografia personale dhe dokumentet e nevojshme me të cilat dëshkohet përmbushja e kushteve nga pika II e këtij vendimi, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, mund ti t'i parashtrijnë deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

IV. Ky vendim do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetata "Nova Makedonija", "Sloboden Peçat" dhe "Koha".

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 08 - 6031/1
18 tetor 2018
Shkup

KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

M-r Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

ZËVENDËSSEKRETARI GJENERAL I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Nexhbedin Ibraimi

Në bazë të neneve 47, 48-a dhe 48-b nga Ligji për ndalimin e korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 18 tetor 2018, solli

**VENDIM
PËR PUBLIKIM EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT SHTETËTOR PËR NDALIM TË KORRUPSIONIT**

1. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikon se do të bëjë emërimin e pesë anëtarëve të Komisionit shtetëror për ndalimin e korrupsionit.

2. Për anëtarë të Komisionit shtetëror për ndalimin e korrupsionit mund të emërohet person i cili i përmbushë kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë;
- të ketë të mbaruar arsim sipëror nga sfera e jurisprudencës dhe punëve financiare dhe antikorrupsionit, të gëzojë reputacion në kryerjen e funksionit dhe së paku tetë vite përvojë pune.

3. Kandidatët e interesuar fletëparaqitjet për pjesëmarrje në këtë shpallje, biografia personale dhe dokumentet e nevojshme me të cilat dëshkohet përmbushja e kushteve nga pika 2 e këtij vendimi, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, t'i parashtrijnë deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

4. Ky vendim do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetata "Nova Makedonija", "Sloboden Peçat" dhe "Koha".

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 08 - 6033/1
18 tetor 2018
Shkup

KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

M-r Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

ZËVENDËSSEKRETARI GJENERAL I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Nexhbedin Ibraimi

Thirrje per dorezimin e ofertave

Republika e Maqedonisë

Projekti per përmirësimin e shërbimeve komunale – MSIP

MSIP 2-NCB-002-18

1. Kjo Thirrje për Oferta bëhet në bazë të Thirrjes së përgjithshme për këtë Projekt të shpallur në botimin e UN Development Business, me nr. WB3498-08/16 të datës 04 Gusht 2016 vj. (Botim i shtypur) dhe e shpallur në formë elektronike më 04 Gusht 2016 vj.
2. Republika e Maqedonisë morri kredi nga Banka ndërkombëtare për ripërtirje dhe zhvillim (IBRD) për realizimin e Projektit te dyte për përmirësimin e shërbimeve komunale (MSIP) dhe ka për qëllim që një pjesë të mjeteve të marra nga kjo kredi ti shfrytëzoj për pagesë në bazë të kontratës për "Rekonstruimin e rrugës lokale ne v.b Grupçin dhe v.b Novo Sellë dhe rekonstruimin e rrugës lokale ne v.b Pallatic"
3. Komuna e Zhelinës ju bën thirrje ofertuesve të kualifikuar të japin ofertë për punë ndërtimore të cilat përfshijnë Rekonstruimin e rruges lokale ne v.b Grupçin dhe v.b Novo Sellë dhe rekonstruimin e rrugës lokale ne v.b Pallatic
4. Procesi i ofertimit do të realizohet përmes procedurave për ankand publik kombëtar si që është e specifikuar në udhëzuesin e Bankës Botërore: Furnizim me mjetet e marra nga hua nga IBRD dhe IDA kredi, nga janari 2011 vj. dhe është e hapur për të gjithë ofertuesit e kualifikuar sikur që është e definuar ne dokumentacionin tenderik.
5. Ofertuesit e kualifikuar të interesuar për pjesëmarrje mund të marrin informata shtesë në adresën e shënuar më poshtë nga 08:30 deri 16:30:
Adresa: Komuna e Zhelinës, f. Zhelinë
Numri postal: 1226
Shteti: Republika e Maqedonisë
Tel: +389(0)44 378 030
Faks: +389(0)44 378 040
Adresa elektronike: adil-emini@hotmail.com
- a) për pagesë në denare:
Banka: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë
Numri i llogarisë: 10000000063095
Llogaria e shfrytëzuesit buxhetor: 726014097563011
Konto e të hyrave: 724125 00
Shuma: 3,000 denare
6. Dokumentacioni tenderues do të dërgohet në formë elektronike ose mund të merret në komunën e Zhelinës.
7. Ofertat duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme deri më ora **12:00, 27.11.2018 vj.** Forma elektronike e dërgimit të ofertave nuk është e lejuar. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen në prani të përfaqësuesve të operatorëve ekonomik të cilët do të zgjedhin të marrin pjesë personalisht, në adresën e shënuar më poshtë më **12:00 h, 27.11.2018vj.**
8. Të gjitha ofertat duhet të kenë të bashkangjitur garancionin bankar në vlerë prej **900.000,00 denarë.**
9. Adresa: Komuna e Zhelinës,
fshati Zheline,
Numri postal: 1226
Shteti: RM

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159 dhe 164-b i Ligjit për mbrojtje shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/12145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimin për punësim nga Ministria e financave nr. 18-3048/2 të datës 12.03.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 04-42/25 dhe nr. 04-42/26 të datës 19.10.2018 nga U.D Drejtori i IPSHU Klinika për gjinekologji dhe obstetrikë publikon

**SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar**

1. IPSHU Klinika për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup ka nevojë për punësimin e :
2 (dy) mjek të medicinës specialist i pediatriisë
1 (një) mjek të medicinës specialist i anesteziologjisë
2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore
 - Të jetë shtetas i RM;
 - Të jetë i moshës së rritur;
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
 - Të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
3. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Të kenë arsim sipëror të mbaruar (7-1) – Fakulteti i mjekësisë;
 - Provim të dhënë profesional;
 - Licencë për punë;
 - Sukses të arritur mesatar në të gjitha lëndët e të gjitha cikleve të studimeve universitare që ka mbaruar kandidati prej së paku tetë (në tekstin e mëtejshëm: suksesi mesatar) dhe
 - Në mënyrë aktive të njeh një prej tre gjuhëve të përdorura më së shpeshti në Bashkimin Evropian (angleze, gjermane ose frënge) në nivelin B2 sipas Kornizës së përbashkët referente evropiane për mësim, ligjërime dhe vlerësim të gjuhëve (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejshëm CEFR), dhe të posedojë një nga certifikatat e pranura ndërkombëtarisht e dhënë nga testatori oficial evropian anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 CEFR, gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 500 pikë, TOEFL CBT së paku 175 pikë ose TOEFL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Gëte certifikatë (Goethe – Zertifikat), TestDaF.
 - Me dhe pa përvojë pune.
4. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt;
 - Biografi të shkurtë (CV);
 - Diplomë me sukses mesatar;
 - Njohja e gjuhës së huaj nga paragrafi 1 i këtij neni dëshkohet me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave të përdorura ndërkombëtare: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEC, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gëte Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të B2 nivelit të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim, ligjërime dhe vlerësim të gjuhëve (CEFR).
 - Njohja e gjuhës së huaj nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç se me certifikata të njohura ndërkombëtare ose certifikata të përdorura ndërkombëtarisht, dëshkohet edhe me vërtetim për mbarim të ciklit të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lart të radhitura në Shanghai Ranking – ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më së shpeshti të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidati posedon diplomë të nostrifikuar.
 - Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
 - Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
 - Certifikatë për arsim të mbaruar në pajtim me nevojat që kërkohen për vendet e lartpërmendura të punës, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
 - Certifikatë për provim të dhënë shtetëror, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
 - Vendim për mbarim të specializimit (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
 - Licencë për punë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
5. Oarari i punës është 40 orë në javë me ndërrime me neto pagesë themelore prej 39.000,00 denar për mjek specialist .
6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
8. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësisht të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Klinika universitare për gjinekologji dhe obstetrikë – Shkup rr. "Majka Tereza" nr. 17, përmes postës ose në arkivin e Klinikës, me shenjë për Shpallje publike për punësim
Ky vendim hyn në fuqi prej ditës së prurjes.

IPSHU KLINIKA PËR GJINEKOLOGJI
DHE OBSTETRIKË – SHKUP

Kur pacientët me insuficencë të zëmres janë në një fazë të përparuar, por nuk mund të transplantohen, mjekët implantojnë pajisjen që ndihmon pompën e zëmres. Ky robot i butë është bërë në vend të materialeve të ngjashme me ato të shtresave të jashtme të zëmres

Kur pacientët me insuficencë të zëmres janë në një fazë të përparuar, por nuk mund të transplantohen, mjekët implantojnë pajisjen që ndihmon pompën e zëmres. Ky robot i butë është bërë në vend të materialeve të ngjashme me ato të shtresave të jashtme të zëmres

Jo vetëm që ndihmon zemrën për të rrahur, por e mbron atë si një mbështjellëse e butë duke e bërë atë të rifitojë fuqinë dhe funksionin e humbur.

Është një robot i ri, i realizuar nga studiues të Universitetit të Harvardit dhe Spitali i Fëmijëve të

KY ËSHTË ROBOTI QË I MUNDËSON ZEMRËS TË RRAHË SA MË MIRË



Bostonit, i cili në të ardhmen mund të tërhiqet nga zemra artificiale dhe të përdoret për ata që presin për transplantim, transmeton Atsh.

Studimi, i udhëhequr nga Frank Pigula, është botuar në revistën "Science Translational Medicine".

Redukton rrezikun e mpiksjes dhe infeksioneve

Kur pacientët me insuficencë të zëmres janë në një fazë të përparuar, por nuk mund të transplantohen, mjekët implantojnë pajisjen që ndihmon pompën e zëmres. Por, ekziston rreziku i infeksioneve dhe mpiksjeve, sepse

valvulat dhe pompat vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me gjakun. Ky robot i butë është bërë në vend të materialeve të ngjashme me ato të shtresave të jashtme të zëmres, duke reduktuar kështu rrezikun e infeksioneve.

Si e ndihmon roboti zemrën Roboti i butë ndihmon zemrën për të rrahur duke aplikuar dhe alternuar presionin dhe thithjen. Sinjalet e një stimulusi kardial tregojnë kur dhe si të lëvizin, duke i bërë ata të imitojnë ritmin natyror të zëmres së dobësuar. Roboti kthehet dhe fasha në sinkronizim me rrahjen e zëmres, duke rritur kështu funk-

sionet e dobëta të zëmres. Ndryshe nga pajisjet aktualisht në dispozicion që ndihmojnë zemrën në funksionet e saj, roboti nuk është në kontakt të drejtpërdrejtë me gjakun duke reduktuar rrezikun e mpiksjes dhe eliminimin e nevojës për të marrë antikoagulantë potencialisht të rrezikshëm.

Një pajisje me potencial të konsiderueshëm

Te derrat, zemra e të cilëve rrihte vetëm 47%, roboti i ktheu funksionet e saj në 97%. "Zemra e shumë njerëzve me insuficencë mban ende një pjesë të funksionalitetit. Në të ardhmen, roboti mund të ndihmojë zemrën për të punuar mjaft mirë dhe për të rikthyer cilësinë e mëparshme të jetës", shpjegon Pigula.

Ajo gjithashtu mund të veprojë si një urë transplantimi dhe të ndihmojë me rehabilitimin kardial. Për shkak se është fjala për t'u zbatuar tek njerëzit, megjithatë, robot duhet të mbajë teste të tjera të lidhura me sigurinë.



"Insta 360", kamera që synon të mposhtë GoPro

"Insta360" thotë se opsioni për të filmuar nga të gjitha anët njëkohësisht (360 gradë) dhe niveli i lartë i stabilizimit të figurës, i bën një kamera më të mirë se GoPro.

Por po tregohen modestë, sepse kjo kamera ka dhe një opsion që të lëshohet si raketë. Gjatë kohës së fluturimit mund të vazhdojë të filmojë 360 gradë.

Kjo do të thotë që nuk ka rëndësi se në ç'pozicion po rrotullohet gjatë fluturimit. Pozicionin që të nevojitet mund ta përzgjedhësh më pas, sepse kamera ka filmuar në çdo anë.

Versioni "One X" filmon me rezolucion 5.7K me shpejtësi 30 foto për sekondë, 4K me 50 foto për sekondë, 3K me 100 foto për sekondë, gjë që mundëson që videoja të luhet shumë ngadalë, pa i shpëtuar as një e qindta e sekondës nga gjërat që ndodhin rreth e rrotull.



Vjen treni më i shpejtë se aeroplani

Një tren i shpejtësisë së lartë i destinuar për të transportuar pasagjerë në mbi 1.100 kilometra në orë (700mph) u zbulua të martën në Cadiz të Spanjës. Sipas Hyperloop Transportation Technologies (HTT), mjeti është ndërtuar për të shkallëzuar vonesat dhe për të transportuar pasagjerët me shpejtësi super të shpejtë përmes tubave magnetikë.

"Sot kemi zbuluar një lloj të ri të mjetit të transportit të ndërtuar me një përqindje të lartë të përbërjes industriale, gjë që e bën Hyperloop ndoshta automjetin më të sigurt të transportit në botë", tha Rafael Contreras, bashkë-themelues dhe kryetar i kompanisë.

Pse celularët janë të ndaluar gjatë fluturimit?

Të gjithë e kemi dëgjuar atë kërkesën e mërzitshme për ta fikur celularin përderisa kemi qenë duke e përdorur në avion.

Si mundet që disa sinjale aq të dobëta si të celularit të ndikojnë në një avion që është mijëra ton? Shumë njerëz mendojnë se kjo ka filluar të praktikohet pas sulmeve të 11 shtatorit, dhe vazhdon të përdoret për t'iu dhënë pasagjerëve një ndjenjë të qetë.

Por, kjo nuk është arsyeja e vetme. Cila është arsyeja e vërtetë? Shumica e celularëve kanë Wi-Fi, kështu që ju nuk keni nevojë që ta



ndalni "Airplane mode" përderisa mund të dërgoni mesazhe përmes WhatsApp apo të bëni thirrje përmes tij.

Por, pavarësisht kësaj, është kurioziteti arsyeja e saktë e këtij nda-

limi nga linjat ajrore ndërkombëtare dhe kombëtare..

E vërteta është se ekzistojnë dy organizata federale të cilat kanë juridiksion mbi përdorimin e celularëve përgjatë fluturimeve. Këto

dy organizata kanë rregulla të cilat e rregullojnë përdorimin e celularit në avion, dhe rrallë që i tejkalojnë ato rregulla.

Përderisa avioni është në ajër, celularët fillojnë të marrin sinjale nga shumë kulla dhe kështu i hutojnë këto organizata që kontrollojnë udhëtimet. Kjo mund të ndikojë gjithashtu edhe në valët e lidhjes së kullave me pilotët e avionëve, duket shkaktuar interferencë të valëve—që do të thotë se mund të ketë pasoja serioze më pas, nëse lidhja humbet me kullën.

Ford dhe Volkswagen mund të bashkohen

Cjigantët e automobilave Ford dhe Volkswagen në qershor të këtij viti u bënë partnerë strategjikë, por shumë lehtë bashkëpunimi i tyre mund të arrijë një nivel shumë më të lartë. Analistët nga Detroiti thonë se partneriteti i tyre tashmë tejkalon tregun e automjeteve komerciale dhe se të dyja kompanitë kanë përfitime të konsiderueshme nga ajo, transmeton KosovaPress. Kjo është arsyeja pse disa ekspertë kanë njoftuar se Ford dhe Volkswagen lehtë mund të bëhen partnerë të barabartë dhe të krijojnë kompaninë më të madhe të vetme në këtë industri.

Cjigandit gjerman mund të ba-



shkëpunojë me Fordin në saje të pozitës së fortë të Oval Blu në tregun amerikan, veçanërisht në segmentin SUV dhe kamionçinave. Nga ana tjetër, VW mund të ndihmojë Ford për të hyrë në Evropë,

Amerikën Latine dhe Kinë, ku aktualisht është i dobët.

Përveç kësaj, të dy prodhuesit me siguri mund të përfitojnë nga krijimi i platformave të përbashkëta që do ta bënin më të lehtë për ta

të zgjerimin gamën e modeleve të tyre.

Ford mund të ndihmojë Volkswagens për të riparuar imazhin e "Dieselgate" dhe segmentin e përmendur tashmë të automjetit pick-up. Ekspertët besojnë se momenti i bashkëpunimit të mundshëm është i përsosur. Ford përballlet me sfida të shumta gjatë punës në një transformim radikal të kompanisë.

Ky transformim përfshin heqjen e modeleve tradicionale sedan dhe coupes nga SHBA dhe kalimin në makinat elektrike dhe vetëlëvizëse me zgjerimin masiv të segmentit crossover dhe SUV.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpusëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësimin të nënpusëve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 234/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Agjencioni për barna dhe pajisje medicinale“ për vendet e punës në vijim:

I. UPR0101V01000 Këshilltar për mbledhjen, vendosjen dhe analizimin e të dhënave, Njësia për përkrahje të informacionit, Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme, përkrahje të informacionit dhe administrim - punë teknike I realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveu i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, informatikë, teknikë kompjuterike dhe informatikë
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 25.000,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) I. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 20 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë. Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.
Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.
Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Shtëpia Përmirësuese Edukuese SHPE në Tetovë, në bazë të nenit 58, paragrafi 1, alineja 1, neni 58-a dhe neni 58-v nga Ligji për sanksione („Gazeta Zyrtare e RM“ Nr. 2/06, 57/10, 170/13, 43/14, 166 / 14, 33/15, 98/15 dhe 11/16), në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 149/09, 16/10, 50/10, 52/10, 124/10, 158/10, 47/11, 11/12, 39/12, 52/12, 13/13, 25/13, 54 / 13, 170/13, 187/13, 34/14, 113/14, 145/14, 20/15, 33/15, 72/15, 74/15, 129/15, 167/15, 27/16 dhe 120/18) dhe neni 20-g i Ligjit për Punësim në Sektorin Publik („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), shpall

SHPLLJE PUBLIKE Punësim në SHPE përkatësisht në Shtëpinë Përmirësuese Edukuese

I- SHPE Shtëpia Përmirësuese Edukuese në Tetovë ka nevojë për punësim të personave **me afat të pacaktuar për vendet e punës:**

1. **Mbikëqyrës i vjetër** për mirëmbajtjen e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm, anëtar i policisë së burgut, shkalla V2 - 2 (dy) realizues.
2. **Mbikëqyrës i lartë** për mirëmbajtjen e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm, anëtar i policisë së burgut, shkalla V1 – 1 (një) realizues

II – Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në mënyrë aktive të flet gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- vendim gjyqësor që nuk e ndalon kryerjen e një veprimtarie ose detyrë profesionale

III – Kushte të posaçme për vendet e punës:

- Për vendin e punës me numër rendor 1:**
- shkalla e kualifikimit V A dhe shkalla e kualifikimit IV sipas kornizës së Maqedonisë dhe 180 ose 240 kredi të fituara, sipas ECVET ose MKSOO ose së paku arsimim të lartë apo të mesëm;
 - të paktën dy vite përvojë pune në profesion;
 - të ketë aftësi psikofizike për kryerjen e punës të policisë së burgut.

Për vendin e punës me numër rendor 2:

- shkalla e kualifikimit V A dhe shkalla e kualifikimit IV sipas kornizës së Maqedonisë dhe 180 ose 240 kredi të fituara, sipas ECVET ose MKSOO ose së paku arsimim të lartë apo të mesëm;
- të paktën tre vite përvojë pune në profesion;
- të ketë aftësi psikofizike për kryerjen e punës të policisë së burgut.

IV – Shkathësi të veçanta për vendin e punës

Për të gjitha vendet e punës – njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, njohje aktive të një prej tre gjuhëve më të folura në bashkimin Evropian (gjuhë angleze, gjuhë frengje dhe gjuhë gjermane) duke patur një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga një kontrollues zyrtar evropian, anëtarë i shoqatës ALTE i kontrolluesve evropian, ose vërtetim nga institucionet ndërkombëtare, shkalla A1 CEFR, përkatësisht BULATS ose Apts; ose TOEFEL PBT më së paku 310 pik, TOEFEL CBT më së paku 35 pik ose TOEFEL IBT më së paku 10 pik, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete

V – Dokumentet e duhura:

- CV e shkurt (me numër kontakti, adresë elektronike dhe adresa e banimit);
- vërtetim nënshtetësie;
- diplomë/certifikatë për arsimimin e kryer;
- vërtetim për gjendjen shëndetësore dhe psikofizike për kryerjen e detyrës në vendin e punës;
- vërtetim që nuk ka ndalesë me vendim gjyqësor për kryerjen e profesionit;
- vërtetim për përvojën e punës në profesion;
- vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike dhe
- vërtetim për njohje aktive të një prej tre gjuhëve të cilat përdoren në Unionin Evropian.

VI – Orari i punës:

Shuma bruto e rrogës për vendin e punës me numër rendor 1 është 21.581,00 denar rroga fillestare
Shuma bruto e rrogës për vendin e punës me numër rendor 2 është 22.733,00 denar rroga fillestare

Vërejtje: Zgjedhja sipas përkatësisë nacionale do të bëhet sipas rregullave ligjore dhe Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve si ligji i veçantë.

VII. Afati i paraqitjes: 20 ditë e llogaritur nga dita e shpalljes. Kandidatët obligohen të gjitha dokumentet e dorëzuara të jenë origjinal ose të fotokopjuara dhe të vërtetuara në noter. Kandidatët e paraqitur do të informohen për kohën, vendin dhe selektimin në adresën elektronike të tyre.

VIII. Dokumentet mund të dorëzohen: në zarf të mbyllur në arkivin e SHPE Shtëpia Përmirësuese Edukuese Tetovë ose nëpërmjet postës në adresë: SHPE Shtëpia Përmirësuese Edukuese Tetovë Rr. Lubo Bozhinoski Pish pa numër, Tetovë ([me theks .. shpallje për punësim](#)).

IX. Paraqitjet të cilët nuk do të dorëzohen në mënyrë dhe kohën e pacaktuar do të llogariten të pavlefshme, të pakompletuara dhe nuk do të shqyrtohen.

X. Kandidatët e paraqitur të cilët nuk do të pranohen në mënyrë të shkruar do të informohen.

XI. Shpallja do të lëshohet në gazetata ditore "Nova Makedonia", "Sloboden Pecat" dhe "Koha"

SHPE Shtëpia Përmirësuese Edukuese Tetovë

Në bazë të nenit 21, paragrafi 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole publikon:

SHPLLJE PUBLIKE

Për punësim të dy (2) realizuesve për kohë të pacaktuar në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole publikon shpallje për punësim të dy (2) realizuesve për kohë të pacaktuar për pozitat në vijim

1. **Nëpunës i pavarur profesional – punëtorë social i dilomuar**
2. **Nëpunës i pavarur profesional – Psikolog**

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të pacaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të pacaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole

1. **Kandidati nën numrin rendor 1 të ketë së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit sipëror Fakultetin filozofik - punë sociale dhe politikë sociale pa përvojë pune;**
 2. **Kandidati nën numrin rendor 2 të ketë së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit sipëror Fakultetin psikologjik, pa përvojë pune;**
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,**

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrajnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të dy pozitat e punës duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:

- Dëshmi të shtetësisë;
- Certifikatë të mjekut për aftësi të përgjithshme shëndetësore për themelimin të marrëdhënies së punës;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit.
- Biografi të shkurtër;
- Letër motivimi.
- Certifikatë për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës fleksibile prej ditës së hënë deri ditën e premte në m prej ora 07:30 deri 15:30 dhe 08:30 deri në 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23,181,00 denarë.

Me kandidatët e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole, ose përmes postës në adresën në vijim:

rr. Velko Vllahoviq nr. 38A Sveti Nikole
(me shenjë "për shpallje") nr. 04-940/1 e datës 19.10.2018.
Personi për kontakt u.d drejtor Melita Stojkova
Kontakt telefoni 072 210 995

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale Sveti Nikole
U.D Drejtor
Melita Stojkova

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë
SHPLL

Kërkesë për marrjen e A - lejes së integruar ekologjike
Në përputhje me nenin 96 pika 1 dhe në lidhje me nenin 115 pika 7 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë UPI -11/3 nr.1260/2018 nga 25.09.2018 për marrjen e A - lejes të integruar ekologjike

Dorëzues i kërkesës:
Shoqata për prodhim, tregti, transport dhe shërbime Gurorja Tehno Paver DOOEL import- eksport Shkup

Adresa:
Rr.27 nr.28 Radishan Shkup

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:

	Y	X	Y	X	
T1	7563312	4617498	T14	7563956	4617772
T2	7563306	4617509	T15	7563964	4617797
T3	7563315	4617524	T16	7563288	4617690
T4	7563303	4617550	T17	7563301	4617763
T5	7563374	4617578	T18	7563244	4617731
T6	7563370	4617602	T19	7563182	4617525
T7	7563474	4617752	T20	7563165	4617525
T8	7563512	4617773	T21	7563135	4617443
T9	7563528	4617762	T22	7563875	4617309
T10	7563581	4617773	T23	7563744	4617358
T11	7563642	4617742	T24	7563355	4617526
T12	7563725	4617743	T25	7563391	4617561
T13	7563814	4617784			

Personat për kontakt:
L.Mirjana Jovceva, menaxhuese e-mail: Mirjana.ktp@hotmail.com

Kategoria e instalacionit:
Shtojca I
3. Industria e mineraleve,
3.1. Instalacione për prodhimin e gëlqeres në furat rrotulluese me kapacitet mbi 50 t/ditë, ose në furat tjera me kapacitet mbi 50t/ditë
Shtojca II
3. Industria e mineraleve,
3.2. Instalacione për gërmim, thyerje, bluarje, sitje, nxehtjen e lëndëve të para minerale, nëse nuk janë të përfshirë me Shtojcën I nga kjo rregullorë.
3.3 Bazat stacionare të betonit me kapacitetet të përgjithshme të siloseve per beton mbi 50 m³
3. Instalacione për minerale,
Lloji i aktivitetit:
Prodhimi i gurit gëlqeror, gëlqeres së pjekur, betonit
Kapaciteti i projektuar:
Nsjerrja dhe përpunimi i 120000 ton/ditë gurë gëlqeror
Pjekje të gëlqeres 140ton/dite
Prodhimi i betonit 45ton/dite
Kërkesa në formë të shtypur , do të jetë e ekspozuar , për shqyrtim për të interesuarit në afat prej 15 ditëve që nga dita e daljes së kesaj Shpallje në shtypin ditor, në lokalet e :
Në hapësirat e Komunes së Velesit Rr.Panko Brashnarov nr.1 1400 Veles Çdo ditë pune, Sektori për mjedisin jetësor
Në të njetën kohë kërkesa në formë elektronike do të jetë e vendosur edhe në Web faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moep.gov.mk
Të interesuarit informata me të detajuara në lidhje me kërkesën do të mund të marrin në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor (e-mail l.balieu@moep.gov.mk)
Të interesuarit në afat prej 30 ditëve që nga data e shpalljes së kërkesës, kanë të drejtë të parashtrorin vërejtjet dhe komentet e tyre në formë të shkruar deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor Sheshi Presveta Bogorodica nr.3,1000 Shkup.

СТАРТ АПУВАЈ

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për veprimtari inovative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2013, 137/2013, 41/2014, 44/2015, 6/2016, 53/2016, 190/2016 dhe 64/2018), Rregullores për menaxhim të instrumenteve për mbështetje të Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik dhe Rregullores për bashkëfinansim të granteve për shoqëritë e porsaformuara tregtare "start-up" dhe "spin-off". Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik më 22.10.2018 publikon

THIRRJE PUBLIKE

Për parashtrim të propozim-projekteve për financim në

INSTRUMENTIN PËR MBËSHTETJE: GRANTET BASHKËFINANCUESE PËR SHOQËRITË E PORSIFORMUARA TREGTARE "START-UP" DHE "SPIN-OFF"

Instrumenti i dedikohet financimit të mikro ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (jo më të vjetra se 6 vjet) – "start-up" dhe "spin-off" dhe ka për qëllim që të nxisë inovacionin përmes sigurimit të mbështetjes së domosdoshme financiare për aktivitete të hulumtimit dhe zhvillimit.

Me instrumentin sigurohet financim prej **më shumë se 85% (tetëdhjetepesë për qind)** nga buxheti i përgjithshëm për projektin, deri në shumën maksimale prej **30.000 (tridhjetëmijë) euro**. 15% (pesëmbëdhjetë për qind) e tjera nga buxheti i përgjithshëm për projektin duhet të jenë të siguruar nga ana e aplikuesit (mjetet e siguruar nga Fondi në bazë tjetër ose mjete nga cila do ndihmë tjetër shtetërore nuk do të konsiderohen si të pranueshme.)

FONDI I PËRGJITHSHËM

Për financimin e projekteve nga kjo thirrje është siguruar shuma e përgjithshme prej 1.000.000 (një milion) euro, gjegjësisht 61.500.000 (gjashtëdhjetenjë milion e pesëqind mijë) denarë. Mjetet janë siguruar nga buxheti i Republikës së Maqedonisë me mbështetje të Bankës Botërore.

KRITERET E KUALIFIKIMIT

- Të jetë shoqëri tregtare të themeluar në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë;
- Të mos kenë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vjet nga dita e themelimit të aplikuesit deri në ditën e parashtrimit të propozim-projektit deri te Fondi;
- Të jetë mikro ndërmarrje, ndërmarrje e vogël ose e mesme (deri në 250 të punësuar);
- Të ketë shumicë të pronësisë maqedonase (me 50.1% ose më shumë);
- Të jetë në pronësi të subjektit/eve fizik/e dhe/ose mikro ndërmarrje, ndërmarrje e vogël ose e mesme (me shumicë të pronësisë maqedonase me 50.1% ose më shumë) dhe/ose institucion i ciki kryen veprimtari hulumtuese për arsim sipëror, gjegjësisht shkencore (me pjesë pronësore të aplikuesit deri në 20%);
- Të ardhurat vjetore të ndërmarrjes të mos kalojnë 1.000.000 milion euro, sipas raporteve financiare për dy vitet e kaluara fiskalizuese;
- Të mos jetë e lidhur me kapital (sipas Ligjit për shoqëri tregtare) me ndërmarrje tjetër ku të ardhurat e përmbledhura vjetore të të dyja ndërmarrjeve kalojnë 1.000.000 (një milion) euro në dy vitet e kaluara, përveç se në rast të lidhjes me kapital me institucion për arsim sipëror, gjegjësisht shkencore-hulumtuese;
- Të mos ketë të akumuluar më shumë se 200.000 (dyqind mijë) euro ndihmë të rëndësishme të vogël për periudhën prej tri vjetëve fiskale, duke përfshirë edhe shumën e kërkuar të mjeteve nga Fondi;
- Të mos ketë të akumuluar më shumë se 100.000 (njëqind mijë) euro ndihmë të rëndësishme të vogël për periudhën prej tri vjetëve fiskale, duke përfshirë edhe shumën e kërkuar të mjeteve nga Fondi, nëse është aktiv në sektorin e komunikacionit rrugor;
- Të mos jetë ndërmarrje në vështirësi dhe
- Të mos merret me prodhimin e qymyrit.

AKTIVITETET E PRANUESHME

- Aktivitete për hulumtim dhe zhvillim
- Zhvillim të pilot vijave
- Aktivitete për testim
- Shërbime në lidhje me pronësi intelektuale
- Dizajn

Lista e lartpërmendur e aktiviteteve nuk është e kufizuar

KOHËZGJATJA E PROJEKTIT:

Më së shumti deri 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Formularët e plotësuar me rregull së bashku me dokumentet shoqëruese parashtrihen në formën elektronike përmes sistemit të Fondit në linkun në vijim: www.fitr.mk/startapuvaj më së voni deri më 11.12.2018 deri në ora 23.59. Në linkun e theksuar janë të mundshme të gjitha informacionet në lidhje me thirrjen.





DASHI 21. mars - 20. prill

Programi juaj i ditës së sotme do të jetë i dendur dhe intensiv, por vullneti juaj edhe më i vendosur, s'ka si të jetë ndryshe kur temë është presioni juaj i zemrës. Beqarët do fillojnë të ndjejnë diçka të fortë për një mik. Në planin financiar do dini çfarë hapash të merrni.



DEMI 21. prill - 21. maj

Mos bëni komente të nxituara edhe pse mund t'ju vijjnë spontanisht. Duhet të ruani qetësinë në mënyrë që marrëdhënia juaj në çift të mos dëmtohet. Beqarët do kalojnë momente të mira me miqtë dhe nuk do e ndjejnë nevojën për dikë në krah. Financat nuk do jenë të këqija.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Sot nuk do të keni sy për askënd tjetër veçse për personin tuaj të zemrës, ai do të jetë gjithë kohës në mendjen tuaj. Beqarët më mirë të presin edhe disa ditë për të bërë ndryshime. Në planin financiar yjet nuk do ju braktisin asnjë moment.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Do të mbeteni shumë të surprizuar nga rrëfimi i dashurisë që do ju bëjë partneri/ja. Mos e gjykoni, por lëreni që të "shfryhet" dhe të tregojë se çfarë do. Beqarët më në fund do e gjejnë personin e tyre të ëndrrave dhe jeta do ju marrë kthesën. Me financat duhet të tregoheni të matur me shpenzimet.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Kjo javë nuk ka qenë e lehtë për ju, por më në fund gjërat duket se do të ndryshojnë përsa i përket marrëdhënies suaj në çift. Cjeneri kohë për të qetësuar veten dhe partnerin/en. Beqarët do realizojnë disa takime, por asnjëri nuk do ju duket interesant. Buxheti do vazhdojë të jetë delikat.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

E sotmja do të jetë një ditë përgjithësisht e qetë. Cjater pasdites do të arrini të shmangni një gabim, ndërsa për të përmirësuar mbrëmjen shfrytëzoni duke e kaluar përkrah njeriut të zemrës. Beqarët do kenë një ditë të ngarkuar me takime. Financat do varen nga mënyra se si i menaxhoni.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Sot do të jeni një vullkan plotë me ide dhe për partnerin/en nuk do të jetë e lehtë që t'ju rri mbrapa. Por gjithsesi ju mos u ndalni nga asgjë dhe ndiqni inspirimet tuaja. Beqarët do bëjnë disa takime, por asnjë nga personat nuk do ua mbushë mendjen. Financat do dini si t'i menaxhoni.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Ju duhet të ndryshoni menjëherë sjellje e sidomos në drejtim të besimit ndaj personit tuaj të zemrës. Në vend që ta bëni më shumë pas vetes po e largoni dita ditës. Beqarët do jenë të hapur ndaj takimeve të reja dhe madje do pranojnë edhe ftesa për aventura. Në planin financiar ka ardhur momenti për marrjen e masave.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të jetë një ditë ideale për të dashuruarit të cilët falë ndonjë organizimi do të kalojnë çaste të bukura dhe momente romantike përkrah njeri-tjetrit. Beqarët duhet të bëhen gati për ndryshime të mëdha në jetën e tyre sentimentale. Financat janë të mira.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Bëni kujdes që të mos jini të bezdisshëm ndaj partnerit/es, njohja juaj nuk është shumë e thellë, ndaj merrni në konsideratë faktin që mos të prishni atë që keni ndërtuar. Beqarët nuk do arri ta bëjnë dot për vete personin që pëlqejnë. Financat janë delikate, tregohuni të kujdesshëm me shpenzimet.



UJORI 21. janar - 19. shkurt


Mos jini keqdashës në interpretimin e sjelljes së personit që e doni shumë. Mundohuni ta gjeni lumturinë tuaj në gjëra të vogla. Beqarët do realizojnë takime të shumta, por për asnjërin nuk do i rrahë zemra. Në planin financiar duhet të tregoheni të kujdesshëm me shpenzimet që mos të përballeni me pasojat.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Ndryshoni programet tuaja të zakonshme dhe eksperimentoni diçka të re sot duke kërkuar edhe bashkëpunimin e partnerit/es. Nuk do të zhgënjeheni. Beqarët do jenë joshës dhe bindës, kështu do i distancojnë shpejt rivalët. Në planin financiar tregoheni të kujdesshëm me menaxhimin që mos të hasni probleme më vonë.

Mensur Mamuti	KOMPOZITORI HUNGAREZ NË FOTO	QYTETI I LINDJES SE KOMPOZITORIT NË FOTO	PËREMËR PRONOR	AUTORI YNË, CAMAJ	TËRHEQËS
ERA, AJRI					
KËSTET					
PËREMËR VETOR			ROBERT REDFORD ONTARIO		
FËLLIQA					
PËRBUZËS					
LANTANID			NITONI QË ËSHTË NË FRYMËN E ILUMINIZMIT		
KËNGËTARI AMERIKANIM POP				1 ROMAK GAZ HELMUES	
SUEDIA		AKTORJA NORVEGJEZE, ULMAN FUTBOLLISTJA ZVICERANE, BAHMAN			
OBJEKT, SEND				KËNGËTARJA JONË, ORA	ITALIA BANORE E NJË SHTETI AZIATIK QË LIDHET ME ANIMIZMIN TË QENËT I NJOMË AUSTRIA
KOHA	BANORJA E SHBA-VE KËNGËTARJA JONË, QAZIMI				
I PARI I EMIRATIT				GRUAJA E XHON LENONIT, JOKO ZERO	TË ARDHURAT NGA PASURIA E PATUNDSHME
VËZHGIMI					
KËNGËTARJA JONË, AZIRI				NAM, FAMË KUQ (ANG.)	
KOHA	KAMPIONI PËRKUL			GRUAJA E GORBAÇOVIT KUMANOVA	
ENERGJIA		TEMPERATURA RUMANIA		AKTORJA ANGLEZE, PËTSI LUKSEMBURGU	
VEPËR E KOMPOZITORIT NË FOTO					IMPULSI



ZGJIDHJET: FRYMA, RATAT, AI, RR, NDOTA, CINIK, LN, NT, IGI, I, S, LIV, TRUP, AMERIKANJA, EMIRI, ONO, MONITORIMI, ANITA, EMËR, ASI, RAISA, E, T, KENSIT, PRELUDET, I.

shumë i lehtë

6						3	1
			2				
	1	2	6		5		
2	6					7	
4	5			8		1	3
		8				4	2
			4		2	1	
				7		9	
7	4						6

Sudoku

2	4		1		9		8	5
					8			
1	8			2			4	7
9					3			
3	5						7	1
				2				9
6	2			3			5	4
				8				
8	7		4		2		1	6

mesatar

Shumë i lehtë: 675948231, 934127865, 812635479, 263514798, 457289613, 198763542, 386492157, 521376984, 749851326. Mesatar: 247169385, 536748192, 189325647, 912573468, 358694271, 764281539, 621937854, 495816723, 873452916.

MASA TË FTOHTA AJRORE DO TA PËRSHKOJNË BALLKANIN

Ballkani pritet të hyjë në stinën e vërtetë të vjeshtës duke nisur nga java e ardhshme, pas një periudhe me të ngrohtë të pazakontë në pjesën më të madhe të Evropës.

Sipas sinoptikanëve, masat ajrore të ftohta që do të fillojnë të përshkojnë Shqipërinë, dhe rajonin e Ballkanit nga e hëna do të arrijnë 12-15 gradë në zonat e ulëta.

Zonat më të prekura nga i ftohti arktik do të jenë alpet, rajoni i Ballkanit, i Adriatikut, jugu i Italisë dhe brigjet e Tirrenit.

Ndërkohë, nga vendet skandinave do të lëvizë masa ajrore me prejardhje nga Arktiku për në jug të Evropës.

Moti i acartë do të përshkojë Evropën Lindore duke nisur nga e mërkura dhe do të arrijë Mesdheun Verior dhe gadishullin e Ballkanit ditën e enjte, për të kaluar të shtunën në rajonin e Lindjes së Mesme.



Moti i papritur pritet të formojë një ciklon në afërsi të detit Jon, çka do të sjellë përkeqësim të motit dhe shira thuajse në gjithë vendin, por veçanërisht në jug.



'Njeriu' ujk ndodhet në Turqi, berberi publikon pamjet shokuese

Për vetëm 4 ditë, kjo video është shikuar nga 1,4 milion njerëz. Berat Polatoglu, berber nga Diyarbakir i Turqisë, ka publikuar një video në profilin e tij në Instagram një video të shkurtë ku ka gjiruar qimet në shpinën e një klienti të tij.

Janë bërë vetëm 4 ditë nga dita kur e ka publikuar dhe këtë video e kanë shikuar 1,4 milion njerëz deri më tani. Djali i cili shihet në video e ka shpinën dhe trupin të mbushur me qime të zeza dhe të dendura. Barati pasi që ia ka hequr qimet e tepërta, në ato qime mund të bëjë çfarëdo modeli që dëshiron. Të pasurit qime të tepëruar në trup mund të jetë edhe sëmundje, e cila ndryshe quhet Hipertrikoza.

Kanë mbetur edhe pak ditë, mësoni kur ndërrohet ora

"Ora diellore" do të hyjë në fuqi natën mes të shtunës së datës 27 dhe të dielës së 28 datës tetor.

Në orën 3:00, akrepat e orës duhet të s'potohen një orë prapa, pra duhet të shënojnë orën 2:00. "Ora diellore" do të qëndrojë në fuqi deri në javën e fundit të marsit 2019.

Ndryshe, në Komisionin Europian është hapur një debat për të braktisur këtë sistem dhe për të lënë

në fuqi sistemin e një ore që nuk ndryshon, duke i lënë mundësi zgjedhjeve shteteve të adoptojnë kë orë të duan. Propozimi ka ardhur nga Presidenti Jean-Claude Juncker dhe nëse pranohet, do të ndryshojë zakonet tona. Arsyja e ndryshimit të orës çdo vit në të gjithë botën ndodh që njerëzit të përdorin më pak energjinë elektrike dhe të shfrytëzojnë më shumë energjinë diellore.



Selfie me përshëndetje si Hitleri, 3 studente rrezikojnë burgun

Të miturit ishin në një udhëtim shkollor: foto është publikuar në Instagram nga një prej tyre dhe më pas anuluar, autoritetet polake kanë identifikuar. Në hyrje të kampit të shfarosjes "Aushvic" në Poloni, tri vajza të mitura në një ekskursion nga shkolli kanë pozuar për një selfie duke bërë përshëndetjen fashiste të Hitlerit. Fotoja është publikuar më pas në Instagram, por autorja e postimit, e ka fshirë menjëherë. Megjithatë, autoritetet polake i kanë identifikuar vajzat dhe tani ato rrezikojnë deri në 3 vite burg.

"Një sjellje e tillë është tronditëse dhe e tmerrshme. Arsimi dhe ndjeshmëria ndaj fatit tragjik të të gjitha viktimave të Aushvicit janë shumë të rëndësishme", tha Bartosz Bartyzel, zëdhënësi i muzeut.

Në Poloni nuk ekziston ndonjë ligj specifik që ndalon faljen e nazizmit apo fashizmit. Në çdo rast, ata që ndihen të ofenduar nga gjesti i tre vajzave mund të



kërkojnë që të zbatohet ligji që i ndëshkon ata që përhapin ndjenjat e urrejtjes me një dënim deri në tre vjet burg. Kjo nuk është hera e parë që ndodhin incidente të tilla. Në vitin 2017 u gjobit një grup studentësh sue-

deze për disa komente të papërshtatshme gjatë vizitës në muze, ndërsa një djalë izraelit uli pantallona e tij në kampin Majdanek, në zonat e Varshavës dhe për gjestin u gjobit me 250 euro.

22 shtatori është dita e 265-të e vitit (266 në vitin e brishtë) në kalendarin gregorian. Ka edhe 100 ditë të mbetura deri në fund të vitit. Kjo është shpesh dita e ekuinoks vjeshtor në hemisferën veriore dhe në ditën e ekuinoksit të pranverës në hemisferën jugore.

66 – Perandori romak Neron krijon Legjionin I Italic.

904 – Kryekomandant Zhu Quanzhong vret Perandorin Zhaozong, perandorin e parafundit e dinastisë Tang, pasi vënë nën kontroll të qeverisë perandorake.

1598 – Dramaturgu anglez Ben Jonson vret një aktor në një duel dhe akuzohet për vrasje.

1789 – Themelohet Zyra Prokurorit të përgjithshëm në Shtetet e Bashkuara.

1789 – Beteja e Rymnik përcakton Aleksandër Suvorov si një komandant i shquar rus ushtarak pas humbjes së tij të ushtrisë aleate të forcave superiore Perandoria Osmane.

1866 – Beteja e Curupaity në Luftën Paraguai.

1869 – Opera e Richard Wagner-së Das Rheingold premiera në Mynih.

1885 – Zoti Randolph Churchill bën një fjalim në Ulster në kundërshtim Faqja Rregulle.

1888 – Numri i parë i revistës National Geographic publikohet.

1896 – Mbretëresha Victoria tejkalon gjyshi i saj Mbreti George III si mbretëruer monark më të gjatë në historinë britanike.

1908 – Deklarata bullgare e Pavarësisë është shpallur.

1941 – Lufta e Dytë Botërore: Në hebre Ditën e Vitit të Ri, vrasja gjermane SS 6000 hebrenj në Vinnytsya, Ukraina. Ata janë të mbijetuarit e vrasjeve të mëparshme që u zhvillua pak ditë më parë në të cilat rreth 24.000 hebrenj u ekzekutuan.

Sa më inteligjent të jeni, aq edhe më naiv dukeni

Pavarësisht se mund të duket shumë kontradiktore, personat më inteligjentë janë edhe më naivët apo ata që mashtrohen më lehtë. Psikologët thonë se kjo ka lidhje me egon, sepse sa më shumë inteligjentë të jeni, aq më shumë mendoni se të tjerët nuk mund t'ju vënë në lojë. Por ja që ndodh e kundërta e asaj që mendoni!

Halli i një burri

Një burrë rreth të 50-ve pësoi një aksident shumë të rëndë nga i cili humbi për fatin e tij të keq "mikun". Kur shkoi për t'u vizituar te urologu, ky i fundit i dha shpresë:

– Tashmë shkenca ka evoluar dhe tani edhe ti ke mundësi ta rikuperosh "mikun" tënd. Kemi tre lloje: të vogël 2000 Euro, të mesëm 4000 Euro dhe të madh 6000 Euro!

– Jam me dy mendje midis të mesmit dhe të madhit, po do të të falenderoja nëse do më jepje pak kohë sa të pyes edhe gruan time!

Merr në telefon gruan dhe pasi flet me të, kthehet në zyrën e doktorit i mërzitur:

– Hë çfarë të tha gruaja?

– Më tha që, me aq pak sa e përdorim atë, me ato lekë më mirë bëjmë ca rregullime në shtëpi...



Një fjalë nuk vjen kurrë vetëm. Edhe fjala "vetmi" ka nevojë për dikë që të vuajë prej saj.
(José Saramago)



KALENDARI HISTORIK 16 TETOR



A E DINI SE...

BARSOLETA



THËNIA E DITËS